



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Gjuhë Ruse”  
me profil “Përkthim dhe interpretim”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Elida Begaj, PhD
2. Ledina Ferhati, PhD

Prill/ 2023



## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT


Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Ruse” me profil: “Përkthim dhe interpretim”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil “përkthim dhe interpretim” <b>Shënim:</b> Profili: gjuhë, letërsi dhe qytetërim rus prej vitesh nuk ka qënë aktiv sepse nuk ka patur kërkesa, procesi u krye vetëm për profilin përkthim dhe interpretim
4	Urdhëri/ VKM i licencimit:	VKM nr. 359, datë 21.09.1991
5	Urdhëri/ VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/ tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	7 PAE
18	Numri i studentëve:	-
19	Komente/ të tjera:	<b>3 vitet e fundit nuk ka patur studentë të regjistruar. Viti fundit që janë regjistruar studentë është viti akademik 2018- 2019: 5 studentë</b>



## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi përputhet me zhvillimin strategjik të njësisë dhe institucionit. Ai synon formimin e specialistëve dhe përkthyesve të gjuhës ruse. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit përputhet me atë të njësisë që e ofron. Struktura e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike, dega e gjuhës ruse është në përputhje me detyrimet ligjore dhe nënligjor për organigramën. Departamenti ka nevojë të rrisë gamën e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, me qëllim përmirësimin e ofertës së tij akademike. Programi synon nivel 6 të Kornizës shqiptare të kualifikimeve. Kurrikula e tij organizohet me 180 ECTS, në tre vite akademike. Në kurrikul mungojnë orët e studimit në praktikë. Departamenti duhet të rishikojë profilizimin e praktikës profesionale vetëm në insitucione arsimore, me qëllim shtimin e mundësive të praktikës si përkthyes/ interpret, pranë institucioneve me të cilat njësia duhet të bashkëpunojë. Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktika të mira. Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor. Megjithatë, plani mësimor mund të rishihet në mënyrë të tillë që t'i lihet më shumë hapësirë lëndëve që synojnë thellimin e njohurive gjuhësore në gjuhën ruse dhe që përforcojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe shkencore, kombinuar me orët e praktikës. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit. Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit zbaton një procedurë rekrutimi për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme sipas kërkesave të përcjella nga dekanët dhe nga Rektori, konformon statutit, rregullores, nevojave të departamentit dhe akteve të tjere të brendshme. Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.





## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Elida Begaj, PhD dhe Ledina Ferhati, PhD. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Vizita në institucion u krye në 28 shtator 2022. Gjatë saj GVJ organizoi takime me Dekanen e Fakultetit dhe përgjegjësën e departamentit, grupin e vlerësimit të brendshëm dhe NJBSC, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve (Zyra e karrierës dhe alumni dhe Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve), përfaqësues të Zyrës së Burimeve njerëzore, Bibliotekës dhe Sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës GVJ vizitoi gjithashtu ambientet në dispozicion të mësimdhënies dhe të nxëniet në këtë program studimi, sekretariatë mësimore, laboratorin e fonetikës dhe bibliotekën e Fakultetit. GVJ kërkoi gjithashtu edhe disa dokumente shtesë gjatë vizitës, kryesisht të karakterit praktik dhe analitik. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij dhe arriti në konstatimet e mëposhtme, të hartura në formën e këtij raporti të vlerësimit të jashtëm.

Më datë 13.03.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr 1/47 Prot., datë 13.03.2023 dërgohet në institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 28.03.2023 dhe me shkresë zyrtare Nr 574/12 Prot., datë 04.04.2023.

### **GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi draft- raportin, sqaron si vijon:**

GVJ sjell në vëmendje që të gjitha rekomandimet e shkruara kanë për qëllim të vetëm përmirësimin e cilësisë së programit. Po sjellim sërish në vëmendje se në të gjithë standartet është evidentuar fakti, që informacioni lidhet me periudhën në të cilën GVJ ka zhvilluar vizitën në institucion. Gjithashtu, gjatë të gjitha takimeve që janë zhvilluar, GVJ ka qenë i kujdesshëm të informojë se hapësirat boshe të identifikuara janë të detyruar ti përcjellin në raport, sepse lidhet me integritetin e këtij procesi por ka të gjithë dashamirësinë dhe detyrën të evidentojë përtej këtyre hapësirave, rëndësinë e vazhdimësisë së këtij programi, pikat e forta që ka dhe vullnetin e mirë të gjithë stafit për të përmirësuar cilësinë e këtij programi.


### **Lidhur me komentet e nisura është e nevojshme të sqarojmë si më poshtë:**

- Në periudhën kur është zhvilluar vizita nuk ka pasur asnjë student të regjistruar. Është shumë pozitive për të gjithë që ky program ka rinisur regjistrimet me student të rinj të këtij cikli, në relativitetin pranë Bordit, GVJ do të të tregohet e kujdesshme ta evidentojë si fakt.



- Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe grupin e punës është evidentuar fakti që Bachelori nuk kishte të parashikuar temë diplome dhe problematika e zhvillimit të praktikës. Ky fakt edhe mund të ndikonte që këta student të vazhdonin ciklin e dytë të këtij programi apo në shtimin e numrit për regjistrimin në ciklin e parë.
- Lidhur me komentin III dhe IV sjellim edhe njëherë në vëmendje që GVJ ka evidentuar problematikat e hasura në RVB dhe është konsultuar dhe me grupin që ka hartuar këtë raport.
- Sjellim sërish në vëmendje që GVJ kishte të programuar takimin me studentë të ciklit të parë dhe jo studentë të ciklit të dytë apo që e kanë përfunduar këtë cikël.
- Lidhur dhe me shqetësimin e fundit, gjatë takimit me grupin e punës është treguar e kujdesshme të kërkojë përgjigje të pyetësorit nga studentë të ciklit të parë të programit të gjuhës ruse por, nga vetë kronologjia u vërtetua që nuk kishte asnjë student pjesëmarrës nga programi i gjuhës ruse, cikli i parë në këtë pyetësor.

Sa më sipër, GVJ i qëndron vlerësimit të draftit pa bërë ndryshime në raportin final.





**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Gjuhë Ruse” me profil: “Përkthim dhe interpretim”**


**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor “Gjuhë Ruse” me profil: përkthim dhe interpretim” ofrohet në përputhje me përcaktimet e rregullores së ciklit të studimit, me synim kualifikimin e specialistëve të aftë për të vepruar në tregun aktual të punës. Programi synon përgatitjen e specialistëve të ardhshëm të gjuhës ruse në profile të ndryshëm, gjë që nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Njësia synon që me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të aftësojë studentë të përvijojnë studime të thelluara të ciklit të parë në fushën e gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit rus, përkthimit dhe interpretimit, në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore që mbart një institucion i arsimit të lartë në Shqipëri. Program i studimit ofron dije dhe një kulturë të përgjithshme dhe të veçanta, të cilat përputhen me objektivat dhe misionin e institucionit dhe janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b>  <b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b>  <b>2.6.1 viti akademik 2019-2020,</b>  <b>2.6.2 viti akademik 2020-2021 dhe</b>  <b>2.6.3 viti akademik 2021-2022</b>  <b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b>  <b>2.1. Strategjia e FGJH-së</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Vlerat akademike, kulturore kombëtare në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” janë pasqyruar në statutin dhe rregulloren e UT dhe rregulloren e programit të studimit të Bachelor në “Gjuhë Ruse” me profil: përkthim dhe interpretim. Ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe paisjen me diplomë referuar nivelit 6 dhe 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve të shtetit.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b>  <b>1.1. Statuti</b>  <b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b>  <b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b>  <b>2.1. Strategjia e FGJH-së</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>Bazuar në strategjinë e zhvillimit institucional programi i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse” me profil: përkthim dhe interpretim është në përputhje me</p>



<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>qëllimin dhe misionin e UT dhe është integruar në linjë me fushën e studimit brenda njësive bazë përgjegjëse për zhvillimin e tij, Departamentit të Gjuhëve Sllavo e Ballkanike, Dega e gjuhës Ruse. Gjithashtu duke iu referuar misionit të Departamentit dhe kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve, ky profil ka perspektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e kërkimit shkencorë në drejtim të çështjeve me të cilat ndeshet përkthyesi sot, apo çështjeve që lidhen me origjinën, zhvillimin, arritjet dhe vlerat e civilizimit rus.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b></p> <p><b>1.1. Statuti</b></p> <p><b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b></p> <p><b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b></p> <p><b>2.1. Strategjia e FGJH-së</b></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” konsiderohet një profil i nevojshëm dhe në linjë me zhvillimin e shërbimit të përkthimit për kategori të ndryshme përkthimi që kërkohen në vendin tonë. Shërbimi i përkthimit konsiderohet i një rëndësie të veçantë përsa i përket rolit mbështetës në drejtim të plotësimit të nevoja për këtë shërbim. <i>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga Grupi i Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm, nuk faktohet një analizë konkrete e tregut të punës.</i> Programi i studimit Bachelor pasohet me programet e studimit të ciklit të dytë Master në dy drejtime: Master shkencor në “Përkthim dhe Interpretim” dhe Master Shkencor në “Komunikim Ndërkulturorë Turistik”. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe konkretisht Departamenti I Gjuhëve Sllave e Ballkanike, duke vlerësuar potencialin dhe strategjitë e zhvillimit në Shqipëri, si dhe nevojën për specialistë të komunikimit ndërkulturor, përkatësisht ndërmjetës gjuhësor me profil “Përkthim dhe Interpretim” ka vendosur si profilizojë këtë cikël studimesh që shkrin njohuritë gjuhësore me aftësitë profesionale të përkthimit dhe interpretimit si dhe komunikimit ndërkulturor turistik.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b></p> <p><b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b></p> <p><b>2.6.1 viti akademik 2019-2020,</b></p> <p><b>2.6.2 viti akademik 2020-2021 dhe</b></p> <p><b>2.6.3 viti akademik 2021-2022</b></p> <p><b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b></p> <p><b>2.1. Strategjia e FGJH-së</b></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1601 774 1668">Viti përmbushet</th> <th data-bbox="774 1601 997 1668">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="997 1601 1220 1668">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1601 1428 1668">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Viti përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Viti përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Program i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” është në linjë me strategjinë e zhvillimit institucional dhe synon konsolidimin e dijeve, respektimit të lirisë akademike, autonomisë së stukturave përkatëse në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencorë dhe inovacionit në drejtim të avancimit në cilësinë e shërbimeve për palët e tjera. Dokumentacioni i dorëzuar nga UT shpalos ambicjen e tij edhe në drejtim të ndërkombëtarizimit duke lehtësuar shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve. Në përputhje edhe me Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Gjuhëve Sllavo Ballkanike (2021-2024), i vihet theksi procesit të ndërkombëtarizimit, shkëmbimeve mes universiteteve. Disa veprimtari dhe shkëmbime mund t’i gjeni duke vizituar linkun më poshtë: <u><a href="#">Aktivitete Archives - Page 12 of 15 - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (fgjh.edu.al)</a></u></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Referuar statutit të tij të brendshëm si dhe rregullores së Universitetit të Tiranës (UT), institucioni ka një ambicje të qartë në drejtim të zhvillimit në të gjithë drejtimet akademike, si dhe të ndërkombëtarizimit të UT-së. Kjo linjë përkthehet në kontributin konkret në drejtim të prioriteteve të tij akademike edhe në mënyrën sesi është hartuar programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim”, duke iu përshtatur kësaj politike të brendshme të institucionit. <b>Referuar Evidencave:</b> <b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b> <b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b> <b>2.1. Strategjia e FGJH-së</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Balkanike, pjesë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, duke qenë në linjë me prioritetet e institucionit. Mbështetur në të dhënat dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi arritur në konkluzion se emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe stategjisë së tij për zhvillim. <b>Referuar Evidencave:</b> <b>2.6. Planet mësimore ndër vite</b> <b>2.6.1 viti akademik 2019-2020,</b> <b>2.6.2 viti akademik 2020-2021 dhe</b> <b>2.6.3 viti akademik 2021-2022</b> <b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b> <b>2.2. 2.3.1. 2.3.2 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive bazë në UT</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi I.3**  
**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e pt të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” që ofron Dega e Gjuhës Ruse synon të pajisë studentët me një gamë të gjerë njohurish në fushën e gjuhës dhe kulturës ruse, formimin e kompetencave dhe shprehive praktike, aftësi që do t’i mundësojë studentëve komunikim në kontekste të ndryshme të karrierës së tyre profesionale. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartë në planin e tij mësimorë përmes lëndëve të lidhura drejtpërdrejtë me zhvillimin e kompetencave teoriko-praktike që i përgjigjen nevojave të profilit profesional të ndërmjetësit gjuhësor. Por edhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen objektivat akademikë që synojnë t’i japin këtij program studimi dije dhe kompetenca në drejtim të gjuhës, letërsisë dhe qytetërimit rus si dhe përkthimit dhe interpretimit të konteksin gjuhësor. Kjo në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” si dhe Vendimi nr. 879, datë 18.12.2019 i Këshillit të Ministrave dhe nevojat e tregut të punës për përkthyes.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b>  <b>2.6. Planet mësimore ndër vite 2.6.1, 2.6.2, 2.6.3</b>  <b>2.3.4 Rregullore e Programit të Studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me përfaqësuesit e institucionit u shpjegua se nuk ka studime dhe Evidencë të mirëfillta mbi tregun lokal dhe ndërkombëtar për programin në ciklit të parë bachelor “Gjuhë Ruse”, me profil: përkthim dhe interpretim”.  <i>Në këtë kuadër GVJ rekomandon që institucioni për të parashikuar vijueshmërinë e programit dhe planifikuar ecurinë e tij duhet të kyejë përditësojë database e departamentit me gjithë alumni që dhe punët që ata bëjnë aktualisht.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit, kreu II, Neni 3 dhe 4, programi i studimit i orientuar nga parimi i zhvillimit të kompetencave profesionale të ndërmjetësit gjuhësor shpaloset edhe në mënyrën sesi është hartuar kurrikula e programit të studimit, objektivat formuese të tij, syllabuset e lëndëve, literatura e përdorur, balanca e komponentëve mësimore në kategorizimin e lëndëve mësimore të tij. Gjithashtu, referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit të profileve përkatëse, në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka një sërë strukturash, ku mund të mbështetet siç janë: plani mësimor, i cili duhet parë si bazë e formësimit profesional të studentit dhe për këtë është e rëndësishme</p>



	<p>një thellim në dije, njohuri e aftësi specifike të lidhura me rolin e përkthyesit apo studiuesit të gjuhës, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie dhe marrëveshjet për praktikat profesionale.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ rekomandon që institucioni të mundësojë edhe disa orë praktike për studentët e ciklit të parë Bachelor, që do i ndihmonin studentën të kuptonin kompetencat dhe interesat profesionale të studentit, gjë të cilën programi parashikon ta realizojë, duke patur gjithmonë parasysh nevojat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Vetë historiku i Institucionit flet qartë për një përvojë shumë të gjatë, e cila është mbështetur me kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e një programi studimi të ciklit të parë Bachelor. Gjykuar edhe mbi bazën e edukimit dhe eksperiencës së stafit pasi janë shqyrtuar CV-të e secilit prej pedagogëve, ku mund të përmendin se Dega e Gjuhës Ruse përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 pedagogë me gradën “Profesorë të Asociuar” dhe</li> <li>• 3 pedagogë me gradën Msc,</li> </ul> <p>mund të konfirmojmë se kriteri i burimeve njerëzore i përmbush nevojat dhe kompetencat për ofrimin e programit komform fushës akademike specifike.</p> <p>Po kështu edhe githë infrastruktura mbështetëse dhe logjistika e nevojshme bëjnë të mundur zhvillimin e një procesi normal mësimi.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b>  <b>2.2. 2.3.1. 2.3.2 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive bazë në UT</b>  <b>1.9 CV e stafit akademik</b>  <b>1.9.1 CV e stafit ndihmës akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë. Njësitë bazë që ofron Programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil përkthim dhe interpretim” është Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Balkanike.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b>  <b>3.1.8 Urdhër vendim për organizimin dhe funksionimin e njësive në nivel njësie kryesore</b>  <b>2.2. 2.3.1. 2.3.2 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive bazë në UT</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën</p>	<p>Njësitë bazë që ofrojnë këtë program studimi kanë një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit përsa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është</p>



akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë njësisë bazë, Departamentit të Gjuhëve Sllavo-Balkanike, dega e gjuhës ruse, të kenë shanse në rritje për zhvillimi e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu, bazuar në klasifikimin/ kodifikimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim”, profili i ofruar nga UT është në përputhje me statutin e tij të brendshëm dhe rregullores së UT e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për të siguruar koordinimin e strukturave të saj, një sërë hallkash dhe mekanizmash rregullojnë mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Njësia bazë përmes strukturave të saj, koordinatorit të departamenteve, grupit mësues mbikëqyrin, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësues për këtë program studimi. Një sërë dokumentash e përligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit. Kjo vërehet duke iu referuar edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi organizimin dhe funksionimin departamentit, si dhe rregullores mësimore të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim”. <b>Referuar Evidencave:</b> <b>3.1.8 Urdhër vendim për organizimin dhe funksionimin e njësive në nivel njësisë kryesore</b> <b>2.2. 2.3.1. 2.3.2 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive bazë në UT</b>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësues e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet arritja e një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, që mban datën 21.01.2020, me afat 5-vjeçar, me të drejtë shtyrjen e saj, me dëshirën e palëve. Gjithashtu nga analizimi i dokumentacionit të dorëzuar vihet re prania e një sërë marrëveshjeve aktive institucionale Erasmus+ ICM të lidhura me universitete partnere jashtë vendit. Të gjitha këto marrëveshje janë në funksion të realizimit të objektivave formuese dhe shkëmbimit të eksperiencës për të përmirësimin e procesit mësues. Vlen të theksohet se shfrytëzimin sa i mirë i këtyre marrëveshjeve për qëllime të



	praktikave profesionale, aktivitete të tjera me natyrë ekstrakurrikulare, orë të hapura me lektorë të ftuar, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve do të ndihmonin në rritjen e cilësisë në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe gjatë pyetjeve drejtuar drejtuesve të departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike u shpjegua se programi i ciklit të parë Bachelor nuk parashikon praktikë mësimore.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit që ka paraqitur Institucioni dhe gjithë dosjes së dokumentave të vëna në dispozicion , IAL ka argumentuar se programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të krediteve ( ECTS). Programi i studimit është në përputhje me nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe vihet re se është në përputhje me nenet 69-73 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi i studimit është organizuar në 3 vite akademike, i organizuar në tre vite akademike me 60 kredite secili, 180 kredite në përfundim të vitit të tretë. Në përfundim të studimeve ofrohet diploma Bachelor në “Gjuhë Ruse”, e shoqëruar nga profili përkatës. Plani mësimor reflekton shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive përkatëse.</p> <p>Ngarkesa totale në auditor është:</p> <p>Në vitin e parë duhet të zhvillohen 600 orë mësimore për 60 ECTS, sipas përcaktimeve të ngarkesës për ECTS të Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit shqiptar.</p> <p>Në vitin e dytë, ngarkesa mësimore sërish mbulohet me 600 orë mësimore dhe vitin e tretë 560 orë mësimore. Pra në total <b>1760</b> orë mësimore për 180 kredite. Ndër këto <b>1.500</b> orë mësimore, 60% e tyre i takojnë punës së pavarur nga studentën. Kontrolli i dijeve kryhet përmes disa elementëve sic janë: detyrat me shkrim e me gojë, ese, teste, provim.</p> <p>Format e mësimdhënies në planin mësimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione</li> <li>• Seminare</li> <li>• Ushtrime</li> </ul> <p>Jepen kreditet korresponduese për çdo lëndë/ modul dhe për diplomën.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Gjatë vitit të parë të studimeve, Programi i ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” është menduar që t’i ofrojë studentëve njohuri teorike bazë në disa lëndë të përgjithshme si: Gjuhë Shqipe, Gjuhë Praktike Ruse I dhe II, Gramatikë e Aplikuar Ruse, Gjuhë e Folur Ruse, Tipologji Tekstore etj. Sipas planit mësimor (të dorëzuar vërehet se më pas vazhdohet me lëndë më të specializuara në fusha shkencore si: Morfologjia, Leksikologjia, Sintaksa Letërsia, Qytetërim, Përkthim dhe Kulturë ruse.</p> <p><b>Referuar Evidencave:</b></p> <p><b>2.6. Planet mësimore ndër vite, specifikisht dokumenti</b></p> <p><b>2.6.1 viti akademik 2019-2020,</b></p>



	<p><b>2.6.2 viti akademik 2020-2021 dhe</b> <b>2.6.3 viti akademik 2021-2022</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni, Programi i ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Ruse me përkthim dhe interpretim” i ofron studentit përveç lëndëve të njohurive bazë formuese në gjuhën amtare dhe në gjuhë të huaj, ofron edhe njohuri të thelluara përmes lëndëve të specialitetit, si psh: Përkthim Terminologjik. Praktikë Përkthimi</p> <p><b>Referuar: Syllabusi i studimeve të vitit III.</b></p> <p>Këto lëndë që lidhen me specialitetin kanë për qëllim ofrim e njohurive të thelluara për studentët, duke i bërë ata të aftë për aspekte të ndryshme që kanë lidhje me gjuhën e huaj dhe me kulturën që ata studiojnë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga vëzhgimi i planeve mësimore të tri viteve të studimit në programin Bachelor të Gjuhës Ruse, me profil “Përkthim dhe Interpretim” vihet re se plani mësimor përmes lëndëve që studiohen gjatë tri viteve është një program progresiv, pra fillohet me lëndë që ofrojnë njohuri të përgjithshme, bazike dhe shkalla e vështirësisë dhe njohurive vjen e rritet, duke ofruar një paketë të plotë të njohurive dhe terminologjisë me të cilat duhet të jetë i pajisur një interpret apo një studiues i një gjuhe të huaj.</p> <p><b>Referuar:</b> <b>Plani mësimor</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Refruar programit të studimit dorëzuar nga Institucionit, Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil përkthim dhe interpretim” është në përputhje me elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Programi është përpiluar në përputhje të plotë me rregulloren e Departamentit dhe me udhëzimet e Senatit Akademik, ku programet e lëndëve mësimore (<b>Plani mësimor</b>) është i strukturuar me kredite (<b>ECTS</b>). Kreditet janë njësia matëse e ngarkesës studentore. Çdo vit akademik ka <b>60 kredite (1.500 orë mësimore)</b> të ndara në 2 semestra, me nga <b>13 javë secili</b> dhe me nga <b>30 kredite</b>. Ngarkesa në auditor është 20 orë në javë. Ndër këto 1.500 orë mësimore, 60% e tyre i takojnë punës së pavarur nga studentën. Kontrolli i dijeve kryhet përmes disa elementëve sic janë: detyrat me shkrim e me gojë, ese, teste, projekte, prezantime sipas planit mësimor etj. Vërehet se kushti i përputhshmërisë së syllabusit e me të gjithë elementët e kërkuar në aktet ligjore dhe nënligjore plotësohet. Gjithashtu në dokumentacionin e dorëzuar vërehet edhe një document specifik, i cili përcakton Modelin dhe Suplementin e Diplomës, me të gjitha specifikimet dhe detajet e punimit të saj.</p> <p><b>Referuar:</b> <b>Dokumenti 2.5</b> <b>Modeli dhe Suplementi i Diplomës</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas</p>	<p><b>Referuar Evidencë 2.6.2 (syllabuset lëndëve gjatë vitit akademik 2021-2022</b> plan-programi i çdo lënde është menduar të plotësojë kërkesat e Shtojcës Nr.2, të VKM Nr.41, dt.24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, duke përfshirë:</p>



kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kredite, kodin si dhe adresën elektronike të pedagogut;</li> <li>- Përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit;</li> <li>- Konceptet themelore, temat e lëndëve</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është një njësi e Universitetit të Tiranës, pjesë e të cilit është Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike, ku dega e gjuhës ruse ofron programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim. Pra Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p><b>Referuar:</b>  <i>Evidencë 2.3.1 Rregullore e Njesisë Bazë</i>  <i>Evidencë 2.3.2 Rregullore e Njesisë Kryesore</i>  <i>Evidencë 2.3.3 Rregullore e FGJH-së 2003</i>  <i>Evidencë 2.3.4 Rregullore e FGJH-së 2010</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	<p>Njësia bazë ku bën pjesë programi i studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike me anë të shkresës që mban datën <b>09.04.2019</b> ka caktuar në rolin e kordinatores së programit të gjuhës ruse Prof.As. Dr. E. Sh, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e procesit mësimor, kordinimin e punës për hartimin dhe përmirësimin e rregullores së programit të studimit, paketës së praktikës dhe paketës së punimit të diplomës.</p> <p><b>Referuar:</b>  <i>Rregullore e Njesisë Bazë</i>  <i>Evidencë 2.8 Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit; detyrat e kordinatorit të programit;</i>  <i>Evidencë 2.8.1 Kërkesa nga dekanati për emërimet e kordinatorëve</i>  <i>Evidencë 2.8.2 Detyra e përgjegjësit të komitetit shkencor e koordinatorit të programit;</i>  <i>Evidencë 2.8.3 Komitetet shkencore dhe koordinatorët për gjuhët sllave e ballkanike</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Referuar organigramës Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike ka në strukturën e vet një drejtues dhe personelin përkatës (sipas rregullores së Njesisë Bazë).</p> <p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është Njësia Kryesore dhe Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike është Njësia Bazë.</p> <p>Përvec pedagogëve me kohë të plotë, pjesë e organigramës së departamentit është edhe stafi me karakter administrativ si: Sekretaria</p>



	Mësimore, Zyra e Karrierës, Zyra e Këshillimit të Studentëve, Zyra e Financës, Biblioteka etj. Në tre vitet e fundit ai reflekton qëndrueshmëri të stafit me kohë të plotë.								
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Sipas jetëshkrimeve të dorëzuara nga Institucioni, ky i fundit ka në përbërjen e vet për ciklin e parë “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” 5 anëtarë të përhershëm me grada/ tituj shkencorë dhe me eksperiencën e duhur në funksion të qëllimeve të institucionit. Konkretisht për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në këtë ciklet të parë të studimeve 5 pedagogë të brendshëm/ me kohë të plotë, kontrata PAE: <ul style="list-style-type: none"> <li>• 3 pedagogë me titull Profesor i Asociuar</li> <li>• 2 pedagogë Msc (të dhënat e marra nga jetëshkrimet e dorëzuara si dokumentacion)</li> </ul> Ndërsa me kontratë PAK pjesë e këtij cikli studimesh janë 2 pedagogë me gradën Msc. Referuar sa më lartë konkludojmë se Dega e Gjuhës Ruse ka përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimeve të personelit akademik, sipas kërkesave të VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.								
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni (Aneksi/Tabela Përmbledhëse, ku cilësohet numri i personelit për çdo njësi bazë) rezulton se Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, ku ofrohet programi i ciklit të parë Bachelor me profil “Gjuhë Ruse me profile përkthim dhe interpretim” janë 10 pedagogë me kohë të plotë, me tituj/grada shkencore. Gjatë vitit akademik, 2018-2019 gjuha ruse ka patur 5 staf akademik me kontratë (PAK). Viti akademik 2019-2020 pjesë e departamentit kanë qenë 3 staf akademik me kontratë (PAK), ndërsa gjatë vitit akademik 2020-2021 vërehet se nuk ka personel akademik me kontratë (PAK).								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike disponon dokumentacionin e nevojshëm bazë mbi të cilin funksionon dhe menaxhohet programi i ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” që përcaktojnë kornizën ligjore të funksionimit të programit, strukturën akademike që e ofron, objektivat e programit, planin mësimor, procedurat e diplomimit. <i>Referuar: Rregullore e programit të studimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module,	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



<p>praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p><i>Referuar: Syllabuset e programit mësimor</i> vëret se programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore. Kjo konkretisht në përputhje me VKM Nr.41, dt.24.01.2018 “për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.</p> <p>Në planin mësimor ngarkesa mësimore është e përcaktura qartë po ashtu edhe forma e mësimdhënies për çdo lëndë. Strukturimi i lëndëve është i përshtatshëm për realizimin e objektivave formuese të programit. Programi ofrohet me kohë të plotë, për 3 vite akademike, në gjuhën ruse, me 180 kredite ECTS, në total, pra 60 kredite për një vit akademik. Sic e konfirmuam edhe më sipër programi është në përputhje me nivelin 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Referuar dokumentacionit vënë në dispozicion nga Institucioni, për çdo lëndë/ modul përcaktohen kreditet sipas sistemit ECTS, detyrimet e shlyerjes, praktikat mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij. Shpërndarja e krediteve bëhet në përputhje me kërkesat e shtojcës Nr.1, VKM Nr.141, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p> <p><i>Referuar: Vendimi nr. 41, dt. 24.01.2018</i></p> <p>Kurrikula është e organizuar në lëndë dhe module, të cilat vlerësohen me kredite (ECTS). Për tre vite studentët duhet të sigurojnë 180 kredite.</p> <p>Ndarja e lëndëve mësimore referuar: <b>Planit mësimor/syllabusit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëndë bazë 32 kredite</li> <li>• Lëndë karakterizuese- 92 kredite</li> <li>• Lëndë ndërdisiplinore- 24 kredite</li> <li>• Lëndë plotësuese-24 kredite</li> <li>• Detyrime përmbyllëse-8 kredite</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Referuar Planit Mësimor të ciklit të parë të studimit vërehet se janë përcaktuar qartë ngarkesa mësimore, orët në auditor dhe ato jashtë auditorit. Në total për tri vite janë 4500 orë, nga të cilat 1760 janë brenda në auditor /20 orë në javë dhe pjesa tjetër 2700 orë është jashtë auditorit. Përveç ngarkesës mësimore, në planin mësimor janë përcaktuar me detaje edhe frekuentime e ciklit të parë të studimit si dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përmes: detyrave me shkrim e me gojë, ese, testeve, prezantimeve etj. Format e mësimdhënies në planin mësimor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione</li> <li>• Seminare</li> <li>• Laboratorë</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Referuar Rregullores së Programit të studimit, nenit 5 theksohet se numri i kuotave (pranimi i kandidatëve të rinj) bëhet sipas listave të MAS. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja procesi i pranimit të studentëve për ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim është i bazuar dhe funksionon sipas nenit 74 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sipas procedurave të po këtij ligji vërehet se njësia kryesore Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i përcjell Rektoratit kriteret e pranimit në programin e</p>



	ciklit të parë të studimit Bachelor për Gjuhë Ruse me profil: Përkthim dhe Interpretim dhe Njësia Bazë i percjell Njesisë Kryesore kuotat e pranimit për studentët e vitit të parë të programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë Ruse me profil përkthim dhe interpretim"			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ ka shqyrtuar edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e DGJSB. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë me qëllimin për të plotësuar kërkesat e Shtojcës Nr.2 të VKM-së 41, dt. 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, ku përfshihen elementë të tillë si: Konceptet themelore, temat e lëndës Formak e kontrollit të dijeve, frekuentimi Literatura Tipi i lëndë, kreditet, kodin dhe adresën elektronike të pedagogut Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ky kriter është plotësuar nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike dhe çdo ndryshim me qëllim përmirësimi paraqitet në Senat përmes një raporti, i cili merr aprovimin e kësaj instance. <i>Referuar: Evidencës 2.14 Raport mbi ndryshimet 20% të planeve mësimore</i> , vërehet se departamenti ka bërë ndryshime në planin original mësimor me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Plani mësimor i programit reflekton ndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive lëndore dhe moduleve përkatëse dhe pasqyron ngarkesën e tyre në kredite të shprehur në teori/ praktikë, në orë studimi në auditor dhe orë studimi individual. Ngarkesa e krediteve është llogaritur sipas ndarjes leksion/seminar. Institucioni ka paraqitur në mënyrë të ndarë ngarkesën mësimore sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë/ modul.  Në total për tri vite janë <b>4500</b> orë, nga të cilat: <ul style="list-style-type: none"><li><b>1760</b> janë brenda në auditor /20 orë në javë dhe <b>2700</b> orë është jashtë auditorit.</li></ul> Të dhënat për ndarjen e orëve në auditor sipas formave të mësimdhënies janë: <ul style="list-style-type: none"><li>Syllabuset në dosje janë sjellë me elementët përbërës të tyre.</li></ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>Syllabuset e lëndëve përmbajnë elementët e domosdoshëm sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.41, datë 24.01.2018.</li> </ul> <p><i>GVJ rekomandon rishikimin në kurrikul sa më sipër, duke sugjeruar një përditësim të literaturës me tituj të 5 viteve të fundit. Në këtë mënyrë programet e lëndëve do të jenë të përshtatshme dhe në koherencë me objektivat formuese dhe me objektivat tërësore të këtij programi studimi.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Referuar Programit të Studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim vërehet se kurrikula është e detajuar dhe e përshtatshme sa i takon njohurive gjuhësore të gjuhës ruse dhe në fushën e gjuhës, letërsisë, historisë e qytetërimit rus, interpretimit dhe përkthimit. Nga kurrikula shohim se studenti merr njohuri në lëndë që i vijnë në ndihmë për marrjen e njohurive të përgjithshme formuese në gjuhën amtare A, lëndë hyrëse në gjuhën B, lëndë specifike që i përkasin fushës së specializimit. Për formimin kulturor të studentit është parashikuar ofrimi i letërsisë së gjuhës ruse në dy module, ku analizohen dhe studiohen kryesisht autorë klasikë.</p> <p>Përvec gjuhës B ofrohen si gjuhë C gjuha angleze dhe gjuhë të tjera perëndimore (me zgjedhje) për tri vite. Si gjuhë D ofrohen të gjitha gjuhët tjetër sllave ( me zgjedhje)</p> <p><i>Referuar: <b>Syllabusit</b></i></p> <p>E gjithë kurrikula është menduar dhe ka për qëllim aftësimin dhe ofrimin e njohurive dhe aftësive për përgatitjen e specialistëve të ardhshëm të gjuhës ruse, duke u siguruar atyre mjetet e nevojshme shkencore për një formim të përgjithshëm dhe të specializuar fushën e studimit dhe për përgatitjen dhe përshtatjen sa më mirë me tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Gjatë analizimit të programit trevjeçar të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” shihet qartë se shpërndarja e lëndëve/ moduleve në semestra dhe vite si dhe vlerësimi më kredite e orë mundëson objektivin kryesor të programit që është formimi i përgjithshëm dhe sa më i plotë dhe aftësimi profesional i studentit. Shpërndarja e moduleve në semestra dhe vite është bërë në funksion të prezantimit dhe rritjes së njohurive dhe aftësive në mënyrë graduale të studentit deri në aftësim të plotë dhe kompetent të tij. Ngarkesa mësimore është graduale dhe organike. Studentët në këtë mënyrë arrijnë të përvetësojnë dhe përthithin të gjithë materialin e vënë në dispozicion të tyre duke e kthyer në dije dhe njohuri veti.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion u vu re se struktura e programit është në përputhje me standardet e Departamenteve të tjera të Gjuhëve të Huaja, sipas sistemit të Bolonjës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe</p>	<p>Vihet re se fusha të ndryshme shkencore që mbulojnë lëndët e programit të studimit bëjnë të mundur punësimin e të diplomuarve në disa sektorë. (Rregullore e Programit të studimit, Neni 3) dhe gjithashtu studentët</p>



praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	kanë mundësi të transferojnë studimet e tyre. Mobiliteti bëhet Gjithashtu kurrikula e studimit është e kombinuar në mënyrë të tillë që të aftësojë plotësisht studentët, duke kombinuar njohuritë teorike me ato praktike.			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Konstatohet përdorimi i një literature klasike për shkak të natyrës së programit dhe sugjerohet përdorimi edhe më shumë i materialeve dhe informacioneve të kohëve të fundit.			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Modeli i syllabusit i përpiluar sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përvoja akademike e stafit arrijnë të sigurojnë përvetësimin e njohurive dhe kompetencave që pritet të kenë të diplomuarit e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim”			
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil përkthim dhe interpretim” është përpiluar në mënyrë të tillë që studentit t’i ofrohet mundësia të ndjekë një karrierë profesionale në disa profile të ndryshme, por njëkohësisht i lejon atij të thellojë dhe zgjerojë njohuritë e veta duke vazhduar ciklin e dytë të studimeve Master qoftë në profiling “Përkthim dhe Interpretim” qoftë edhe në fusha të ngjashme.			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka dy dokumente të cilat ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulës, përditësimin e saj dhe përshtatjen sa më mirë me kushtet e tregut të punës. <i>Referuar:</i> <b>Evidencës 2.10 Politikat Institucionale të publikimit të informacionit dhe</b> <b>Evidencës 2.11 Politika marketing për programin e studimit, format e tij dhe transparencën me publikun.</b> Departamenti bën takime konsultuese me partnerë dhe bashkëpunëtorë. Konkluzionet e arritura nga këto takime pasqyrohen në kurrikulat e programit, për ta bërë atë sa më të vlefshëm për përvojën studimore dhe praktike të studentit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se personeli akademik i angazhuar në këtë program ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës



<p>pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>në fushën e programit. Personeli akademik i angazhuar në program mbulon ngarkesë mësimore sipas profilit në këtë program, por edhe në programe të tjera. Materiali i dorëzuar nga IAL përmban të gjitha CV e plota të titullarëve të angazhuar në këtë program studimi. Sipas jetëshkrimeve të dorëzuara nga Institucioni, ky i fundit ka në përbërjen e vet për ciklin e parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” 5 anëtarë të përhershëm me grada/ tituj shkencorë dhe me eksperiencën e duhur në funksion të qëllimeve të institucionit. Numri i pedagogëve me kohë të plotë/të brendshëm gjatë viteve akademike 2018-2019 dhe 2019-2020 është shoqëruar edhe me personel akademik me kontratë (me kohë të pjeshme) Ndërsa për vitin akademik 2020-2021 për shkak të numrit të studentëve dhe rrjedhimisht ngarkesës së ulët mësimore nuk ka personel akademik me kontratë.</p> <p>Konkretisht për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në këtë cikël të parë të studimeve 5 pedagogë të brendshëm/ me kohë të plotë, kontrata PAE.</p> <p>Kualifikimi shkencor i stafit akademik, rezulton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 3 pedagogë me titull Profesor i Asociuar</li> <li>• 2 pedagogë Msc (të dhënat e marra nga jetëshkrimet e dorëzuara si dokumentacion)</li> </ul> <p>Referuar sa më lartë GVJ konkludon se Dega e Gjuhës Ruse ka përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimeve të personelit akademik, sipas kërkesave të VKM nr. 418, dt. 10.05.2017, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i CV-ve të dorëzuara, personeli akademik me kohë të plotë në ciklin e parë Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” ka nivelin e kërkuar të kualifikimeve në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sa i takon raportit të gradës/ titullit të personelit akademik dhe pozicioneve që ata mbajnë: Profesor, Lektor, Asistent Lektor rezulton se këto raporte janë në përputhje me nenet 3, 4, 5 të Ligjit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në CV e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme vërehet se edukimi bazë, arsimimi i mëtejshëm plotësues, kualifikimet, trajnimet brenda dhe jashtë vendit dhe kërkimet shkencore janë në përputhje me nivelin e programit të studimit.</p> <p>Niveli i ofruar nga anëtarët e stafit akademik është i lartë dhe në përputhje me kërkesat e Degës së gjuhës ruse.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim</p>	<p>Gjatë ciklit të parë të studimit Bachelor “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim” nuk ofrohen praktika profesionale. Këto të fundit</p>



<p>me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>ofrohen gjatë ciklit të studimeve Master Shkencor në semestrin e fundit të ciklit. Në vitin e tretë, për studentët që plotësojnë kriteret parashikohet edhe punimi i temës së diplomës.</p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ sugjeron shtimin e orëve të praktikës, duke i konsideruar ato si një vlerë e shtuar që do t'i mundësojnë studentëve thellimin e njohurive dhe vënien në praktikë të tyre.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p><i>Referuar: Evidencës 19.1</i> vërehet se përdorimi i laboratorëve është nën përgjegjësinë e pedagogut të lëndës përkatëse. Konfirmohet se departamenti deri më tani nuk ka patur nevojë për mbështetje nga stafi laboratorik, pasi natyra e programit nuk e kërkon atë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Në planin mësimor janë përcaktuar qartë format e mësimdhënies, të cilat janë të ndara sipas orëve në auditor, praktike dhe studim individual. Këto forma, janë në koherencë me praktikën e njohura kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu zhvillimi dhe përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve bazohet kryesisht te pedagogu i lëndës përkatëse dhe kontributi i tij në rishikimin e programeve lëndore në mënyrë të rregullt. Vlen për t'u përmendur se në kushtet e pandemisë Covid-19 ashtu si edhe shumë institucione të tjera arsimore edhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe konkretisht Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Dega e gjuhës ruse filloi mësimdhënien online përmes platformave të miratuara nga MAS.</p> <p><b>Referuar:</b>  <i>Rregullorja e Brendshme e UT "Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19"</i>  <i>Rregullorja e brendshme e UT mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online në Universitetin e Tiranë për sezonin e dimrit të vitit akademik 2020-2021</i>  <i>Udhëzimet për provimet dhe mënyrat e tjera të shlyerjes së detyrimeve akademike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Lidhur me monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në fund të çdo semestri, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon një pyetësor me studentët e programit të studimit, i cili bën të mundur në një farë mënyre vlerësimin dhe matjen e performancës së stafit akademik dhe atij administrativ. Duhet theksuar gjithashtu se gjatë takimit që pati me përfaqësuesit e Njësies së Sigurimit të Cilësisë për çështje të cilësisë në nivel departamenti, kjo strukturë ishte vetë në hapat e para dhe ende nuk kishte gati strukturat e plota të monitorimit.</p> <p><b>Referuar:</b>  <i>Evidencë 3.1.2. Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i>  <i>Evidencë 3.1.7. Rregullore për funksionimin e njësies së sigurimit të brendshëm të cilësisë në FGJH</i>  <i>Evidencë 3.1.8. Vendim për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-së në nivel njësie kryesore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë</p>	<p>Pyetësorët me studentët janë një mënyrë për të marrë mendimin e tyre mbi procesin e mësimdhënies, format dhe metodat e tij, vlerësimi për stafin akademik etj.</p> <p><b>Referuar dokumenteve:</b></p>



mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p><i>Evidencë 3.6. Pyetësi i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies,</i></p> <p><i>Evidencë 3.7. Pyetësi i Gjuhëve Sllavo-Balkanike dhe</i></p> <p><i>Evidencë 3.8. Pyetësi “Vlerësimi i lëndës dhe i pedagogut nga studenti”</i></p> <p>Nga takimi që patëm me përfaqësuesit e NJSBC mësuam se pyetësit bëhen në fund të çdo semestri/ viti dhe për të qenë sa më të vërtetë në dhënien e mendimeve ruhet anonimat. Struktura e pyetësorit përmban tre komponentë për të cilët merret mendim: mësimdhënia, stafi akademik dhe ai administrativ.</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit u ngrit edhe çështja e krijimit të grupit të cilësisë brenda departamentit gjë që do të ndihmonte në rritjen e cilësisë së performancës së departamentit dhe do t'i vinte në ndihmë punës dhe funksionimit sa më normal të NJSBC.</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pas realizimit të pyetësorëve të studentëve Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, pas përpunimit të të dhënave, i përcjell rezultatet e tyre në njësisë bazë. Më pas, njësia bazë realizon diskutimin e rezultateve të vlerësimit dhe ja komunikon ato në mënyrë individuale secilit anëtar të personelit akademik.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	NJSVB promovon shembuj të mirë dhe organizon trajnime në lidhje me metodat e mësimdhënies në funksion të përmirësimit të cilësisë sipas një kalendari që institucioni harton në fillim të vitit të ri akademik. <p><i>GVJ pas vizitës në institucion sugjeron dhe inkurajon shtimin e mekanizmave të vlerësimit për të patur më shumë rezultate dhe mendime të disa grupeve të interesit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se institucioni aplikon si formë kryesore të transmetimit të dijeve leksionet, seminarët, laboratorët e përkthimit, detyrat e kursit dhe praktikën profesionale. Programet e lëndëve pasqyrojnë elementet thelbësore të njohurive, përfshirë format e vlerësimit.</p> <p><b>Referuar:</b>  <i>Planet mësimore 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021</i>  <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara ndër vite</i>  <i>Rregullore e Programit të Studimit</i></p>





	Gjithashtu departamenti organizon edhe leksione të hapura, me lektorë të jashtëm vendas dhe të huaj, të ftuar ku trajtohen tema me interes për studentën e degës.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Personeli akademik siguron një ndërthurje metodash mësimdhënie, në varësi të natyrës së lëndës dhe objektivat për t'u arritur, përfshirë lëndët që kanë orë laboratorike. Metodat e mësimdhënies dhe përbërësit e tjerë të procesit mësimor përcaktohen në programet e lëndëve të hartuara nga pedagogët përkatës. Duke qenë se secila lëndë ka specifikat e veta, pedagogët zgjedhin forma të ndryshme të mësimdhënies për të krijuar interaktivitet aktivizim të studentëve dhe kombinim të aspektit teorik me atë praktik, për të zgjuar interes dhe për të qenë më pranë tregut të punës. Gjithashtu gjatë dy viteve akademike 2020 dhe 2021 Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ka aplikuar e-learning, mësimdhënien përmes platformave online të miratuara nga UT si: Webex Meeting, Microsoft Teams, google meeting, Zoom etj.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Gjatë diskutimeve me pedagogët e Institucionit, GVJ konstatoi se Institucioni i ofron personelit akademik mundësinë e botimit në revistën shkencore të institucionit, kundrejt asnjë detyrimi financiar. Gjithashtu, personelit akademik i ofrohet mundësia e trajnimit lidhur me metodat dhe risitë në mësimdhënie. Institucioni siguron gjithashtu mundësinë e shkëmbimit të stafit dhe pjesëmarrjes në programe të Erasmusit (Bullgari), DAAD, që janë pjesë e marrëveshjeve të Fakulteti ka nënshkruar. Dega e gjuhës ruse është pjesë e shkëmbimeve në projektin CEPUS, por që nuk është shumë efektiv.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Aktualisht, Dega përgjegjëse për këtë program studimit ka të angazhuar staf akademik me kohë të plotë, ndër to specialistë të Gjuhësisë e Përkthimit me tituj e grada shkencore dhe specializime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Referuar CV-ve të shqyrtuara, i gjithë stafi është kompetent në fushat e lëndëve të cilat zhvillojnë.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Pjesë e strategjisë së UT-së është përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të kurrikulës së studimit, me qëllim rritjen e cilësisë së procesit mësimor. Mendimi i studentëve dhënë përmes pyetësorëve, focus grupeve të ngritura apo përmes përfaqësimit të tyre në struktura të ndryshme të UT-së, vlerësohet nga institucioni, i cili adreson kërkesat dhe sugjerimet e studentëve në funksion të përmirësimit të procesit mësimor. Pedagogu plotëson formularin e vetëvlerësimit në fund të çdo moduli lënde, të cilin ja përcjell departamentit. Në fund të formularit, lektori ka një hapësirë ku mund të japë sugjerimet apo reflektimet e tij për vitin që vjen.
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Interaktiviteti dhe të menduarit kritik janë qëllimi kryesor i zhvillimit të orëve të mësimit. Lidhur me specifikat e programit të ciklit të parë Bachelor "Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim" për ta bërë studimin më tërheqës shumë rëndësi kanë ushtrimet dhe trajtimet e



	rasteve studimore të ndryshme. Ndërkohë, elemente të tjera përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Studentët nxiten të japin mendimet e tyre kritike lidhur me procesin mësimor, raste praktike me qëllim nxitjen e arsytimit dhe të menduarit kritik. Pedagogët dhe studentët ruajnë një komunikim dhe etikë komunikimi institucional. Nga takimi me studentët u informuam se ekzistonte prirja për të nxitur autonominë e të nxëniet, e ndërthurur me rolin mbështetës dhe udhëzues të pedagogut. <i>Referuar Evidencëve:</i> <i>Rregullore e UT-së</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i> <i>Programet mësimore 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021</i> <i>Raportet vjetore për veprimtaritë e kryera 2020-2021</i> <i>Rregullore e programit të studimit</i> <i>Raporti vjetor 2019-2020</i> <i>Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar por edhe nga konstatimet gjatë vizitës në institucion, u vërtetua se UT ka në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në godinën e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Ka në dispozicion një sipërfaqje të mjaftueshme, në salla leksioni dhe seminari, me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij programi. Sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje përkthimi, videoprojektor dhe kompjutera. Përpos tyre ambiente pune e konsultimi lejojnë shfrytëzimin nga studentët për nevojat mësimore janë ambiente që mund të përdoren nga studentët. E gjithë kjo infrastrukturë mundëson realizimin e orëve të mësimit me metodat dhe teknologjitë bashkëkohore, në përputhje me programin. <i>Referuar:</i> <i>Aneksit RVB, Tab.16 Sipërfaqe e brendshme e çdo hapësirë, viti akademik 2021-2022, cikli i parë</i>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e	Ambientet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, sallat e leksionit janë të pajisura me foni dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike, bibliotekën në fizike në godinën e FGJH-së dhe atë



<p>nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>online. Për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor dhe bashkëkohor, Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike ka në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor 1 sallë leksioni, 3 salla seminaresh dhe 1 sallë konferencash/ aktivitete, me kapacitet të vazhdueshëm</p> <p><b>Referuar:</b> <i>Aneksit RVB, Tab.16 Sipërfaqe e brendshme e çdo hapësirë, viti akademik 2021-2022, cikli I parë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 për shkak të pandemisë Covid-19, sipas udhëzimeve të MAS procesi mësimor u zhvillua online përmes platformave të caktuara si: Zoom, Google Meets, Microsoft Teams etc. Studentët dhe stafi akademik kishin akses të plotë në këto platforma.</p> <p><b>Referuar:</b> <i>Rregullorja e Brendshme e UT “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19”</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Pjesë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është Biblioteka e tij, ku kanë akses të gjithë studentët. Biblioteka ka në dispozicion një fond fizik me libra/ botime në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, të cilat student mund t'i shfrytëzojë sipas nevojave. Gjithashtu stafi dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë në bibliotekën online, vënë në dispozicion pa pagesë nga Fakulteti dhe në eëbsite të Universitetit/ Fakultetit. Për degën e gjuhës ruse Pjesa me e madhe e librave janë dhuratë e Ambasadës Ruse në Tiranë.</p> <p>Në kudër të projektit Clean Score është finalizuar marrëveshja e abonimit në JSTOR për UT</p> <p><b>Referuar:</b> <i>Evidencë 3.9.1. JSTOR</i> <i>Evidencë 3.9.2. Libra të shtuar 2021-2021</i> <i>Biblioteka Online – UNIVERSITETI I TIRANËS (unitir.edu.al)</i> <i>GVJ sugjeron pasurimin edhe me më shumë libra të bibliotekës të cilat do i vijnë në ndihmë procesit të mësimdhënies</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Gjithashtu një ambient që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe bibliotekat digjitale për nevojat e studentëve të këtij programi studimi, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet.</p> <p><b>Referuar:</b> <i>Aneks RVB, Tab.17</i> <i>GVJ sugjeron pasurimin edhe me më shumë libra të bibliotekës online, të cilat do i vijnë në ndihmë procesit të mësimdhënies</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor janë të aksesueshme edhe bibliotekat digjitale, sic përmendëm më sipër aksesit në JSTOR-Biblioteka Online – <a href="http://unitir.edu.al">UNIVERSITETI I TIRANËS (unitir.edu.al)</a></p> <p>Për lehtësimin e përdorimit të bibliotekës digjitale, vërejmë se RASH ka hartuar një manual për përdorimin si dhe aksesimin e saj <a href="http://www.ulibrary.rash.al">www.ulibrary.rash.al</a></p>



përafërta me programin e studimit.									
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Vërehet se infrastruktura laboratorike shfrytëzohet nga studentët sa herë është e nevojshme për realizimin e detyrave dhe studimeve specifike, në funksion të lëndës. <i>Megjithatë, nga GVJ rekomandohet që laboratorit të pajiset me programe (software) të specializuara në shërbim të lëndëve të caktuara që zhvillohen në laborator.</i>								
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT, të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 për shkak të pandemisë Covid-19, sipas udhëzimeve të MAS procesi mësimor u zhvillua online përmes platformave të caktuara si: Zoom, Google Classroom, Microsoft Teams etc. Studentët dhe stafi akademik kishin akses të plotë në këto platforma. <b>Referuar:</b> <b>Rregullorja e Brendshme e UT “Për mbrojtjen nga infeksioni i shkaktuar nga virusi Covid-19”</b>								
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar si dhe platformën Microsoft Teams për zhvillimin e mësimit online. Stafi dhe studentët përdorin outlook për komunikim mes tyre, me adresat individuale me domain të UT-së. Përmes forumeve online studentët mund të marrin informacione në lidhje me jetën dhe aktivitetet studentore, leksionet/ materialet mësimore, administratën etj përmes rubrikës përkatëse në faqen e internetit të fakultetit. <b>Referuar:</b> <b>Evidencë 3.10.1 e-Student Pegagog</b> <b>Evidencë 3.10.2 Manual studimi e-Student</b> <b>Evidencë 3.10.3 Manual Përdorimi I Microsoft Teams</b> <b>Evidencë 3.10.4 Microsoft Office 365 për Studentë</b> <b>Evidencë 3.10.5. Microsoft Office 365 Teams</b> <b>Evidencë 3.10.6. Udhëzues bazik për Microsoft Teams</b>								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studentëve me mesatare mbi 8.5 u jepet e drejta të zgjedhin nëse dëshirojnë të diplomohen me provim formimi apo temë diplome, por kjo ka ndodhur shumë rrallë. Në rastin e diplomimit me temë diplome, departamenti i përcakton një pedagog udhëheqës i cili duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor. Kryesisht student zgjedhin të kalojnë në provim, i cili zhvillohet në formën e një eseje, në varësi të lëndës që student zgjedh për provim.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Për qëllimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë është ngritur dhe vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) si njësi kryesore, në përputhje me aktet e brendshme rregullatore të UT-së. NJSBC-ja ka autonomi të plotë dhe kujdeset për mbarëvajtjen dhe sigurinë e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><b>Referuar Evidencëve:</b>  <b>Statuti UT</b>  <b>Rregullore e NJSBC</b>  <b>Rregullire për sigurimin e cilësisë IAL</b>  <b>Manual i Sigurimit të Cilësisë</b>  <b>Rregullore për funksionimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë në FGJH</b>  <b>UT zbaton një paketë aktesh për sigurimin e cilësisë 3.1, 3.1.1, 3.1.2, 3.1.3, 3.1.4, 3.1.5, 3.1.6, 3.1.7, 3.1.8, 3.1.9</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin e ciklit të parë të studimit në “Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim”, në FGJH. Teorikisht raportit dhe rezultat e nxjerra nga NJSBC i shërbejnë departamentit për të parë praktikata e mira dhe pikat e dobëta ta cilat duhet të adresohen dhe që kërkojnë ndërhyrjen dhe marrjen e masave konkrete me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë takimit të bërë në institucion me përfaqësuesit e kësaj njësie u konstatua që kjo është një njësi e sapoformuar e cila po punon për të vënë standardet e funksionimit të saj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe konkretisht Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike mbështesin me infrastrukturën e duhur metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Rezulton se për shkak të pandemisë Covid-19 semestri i dytë i vitit akademik 2021-2022 e gjeti fakultetin në kushtë jashtë normales, ku mësimi u zhvillua online. Gjithsesi edhe si përvojë të parë, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike e kaloi me sukses këtë sfidë duke e bërë pjesë të procesit të vet të mësimdhënies përdorimin e platformave online.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Dega e Gjuhës Ruse bashkëpunon me strukturat përkatëse në Rektorat për të qënë pjesë e kërkimit shkencor dhe e aplikimit të projekteve ndëruniversitare brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><b>Referuar:</b>  <b>Evidencë 3.9.4 Revista FGJH</b>, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja boton një revistë shkencore. Qëllimi i botimit të revistës është nxitja e botimeve nga stafi akademik i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nxitja e debatit shkencor, promovimi i punës shkencore, institucioni mbështet stafin akademik efektiv për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore dhe avancimin në kualifikimin e tyre.</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja dhe këto procedura parashikohen në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë. Institucioni motivon dhe mbështet trajnimin e stafit në universitetet perëndimore në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit të UT-së me universite ndërkombëtare dhe të projekteve si: Erasmus + KA1 etj.</p> <p><b>Referuar:</b> <b>Evidencëve 3.1, 3.1.1, 3.1.2, 3.1.3, 3.1.4, 3.1.5, 3.1.6, 3.1.7, 3.1.8, 3.1.9</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Ky është një prej detyrimeve bazë I pjesë e marrëdhënieve kontraktuale që stafi akademik ka me UT, në përputhje me dispozitat statutore. I njëjti angazhim vlen edhe për personelin ndihmës akademik të këtij programi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe përditësimin e syllaluseve dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të parashikuar në të, si pjesë e detyrimeve akademike, metodologjinë e mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës etj. <b>Referuar: Evidencë 1.3; Evidencë 1.4</b></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe aplikimin e metodave të reja. Kjo reflektohet në përditësimin e programeve të lëndës dhe diskutimin e tyre në takimet në department.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se rregullorja e programit të studimit përcakton çështje që lidhen me vlerësimin dhe kontrollin e njohurive të studentëve. Kontrolli i dijeve përbëhet nga disa komponentë dhe bëhet përmes testimeve me shkrim, me gojë, përqindjes së frekuentimit të orëve mësimi dhe angazhimit të studentit në klasë dhe jashtë saj, prezantimeve, projekteve, detyrave të kursit, provimit të diplomës, i cili kryhet në përfundim të mbylljes së gjithë detyrimeve akademike të studentit gjatë ciklit të parë të studimit Bachelor.</p> <p><b>Referuar: Evidencë 1.3; Evidencë 1.4; Tabela 15 (RVB)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me</p>	<p>Bazuar në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion dhe kryesisht nga diskutimet me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata</p>



metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	njihen në fillim të çdo lëndë/ moduli me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga pedagogu i lëndës/ modulit.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Për vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara, studentët i nënshtrohen provimeve në mes të semestrit, provimeve përfundimtare, apo temës së diplomës. Duhet theksuar se mënyrat e kontrollit të njohurive përcaktohen edhe në Rregulloren e Programit të Studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Niveli i përvetësimit të dijeve bëhet me system pikësh nga 0-100, e shprehur në % nga 0-100 % dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë 4-10, i shprehur me shkronjat F në A. Nota kaluese janë nota 5 deri në 10 dhe shkronjat nga E në A. <i>Referuar: Evidencë 1.3; Evidencë 1.4</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i provimeve për të qënë sa më transparent dhe objektiv bëhet i sekretuar me bar code. Në kushtet e mësimin online platforma Teams arritit të garantonte informim në kohë reale të vlerësimit të studentit, transparencë dhe shpejtësi. <i>Referuar: Evidencë 1.3. dhe 1.4 Evidencë 3.12. Rregullorja e Posacme e UT-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/ modulit.	Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentëve. Kur lënda ka edhe asistent, vlerësimi bëhet nga të dy pedagogët e angazhuar në lëndë. Pedagogu harton tezat e provimit, të përditësuar për çdo vit. Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë dhe komisioni përcaktohet nga titullari i lëndës, i cili ndjek edhe procesin e provimit nga fillimi deri në fund.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron	Rregullorja e brendshme është dokumenti bazë që sanksionon kriteret e kontrollit të njohurive. Provimet zhvillohet me procedurë sekretimi, ku kredencialet e studentit janë të fshehura derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Pas përfundimit të korrigjimit dhe vendosjes së notës bëhet bashkimi i kodit me emrin e



<p>infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>studentit. Njoftimi i përcillet studentëve përmes sekretarisë online. Gjatë kohës së pandemisë, u aplikua testimi online që ka garantuar shpejtësi maksimale të zhvillimit të procesit dhe transparencë në vlerësim. <b>Referuar: Evidencë: 1.3, 1.4, 3.12</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pas zhvillimit të provimit, në përgjithësi pedagogët diskutojnë me studentët në auditor mbi zgjidhjen e tij. Kjo vlen si për provimin në mes të semestrit, ashtu edhe për provimin përfundimtar. Pas korrigjimit studentit ka të drejtë të njihet me tezën e provimit, pas c' sekretimit të tyre. Në këtë mënyrë ai njihet me pikët që ka marrë në total në provim dhe me pikët për çdo seksion të provimit. Pas njohjes me vlerësimin e tezës ai ka të drejtë të ankimit brenda 48 orëve nga shpallja e rezultatit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullorja e përgjithshme e UT-së dhe Rregullorja e ciklit të parë të studimit Bachelor në "Gjuhë Ruse me profil: përkthim dhe interpretim" parashikon me detaje rregullat për zhvillimin e provimeve, ndalimin e kopjimit, si dhe respektimin e Kodit të Etikës së UT-së. Është detyra e pedagogut që është caktuar në ruajtje për të raportuar shkelje të etikës nga studentët. Gjithashtu Fakulteti ka programe që garantojnë origjinalitetin e punimeve dhe mënjanojnë plagjiaturën në punimet kërkimore që dorëzohen gjatë studimeve të ciklit të parë</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit, stafi akademik ka një afat 5 ditor për vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore. Më pas, sekretaria mësimore njih studentët me rezultatet përkatëse ose studentët mund të njihen me rezultatet nëpërmjet sekretarinë online. Provimet zhvillohet me procedurë sekretimi, ku kredencialet e studentit janë të fshehura derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Në përfundim të programit të studimit, studentëve ju njehsohet nota mesatare e ponderuar që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë tjetër formuese. <b>Referuar:</b> <b>Evidencë 1.3., 1.4. dhe 3.12.</b> <b>Evidencë 3.2 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në <b>Nenin 49</b> të Rregullores së Programit të Studimit, studentit ka të drejtë të kërkojë sqarim për vlerësimin e bërë nga komisioni kur nuk është dakord me rezultatin. Ai njihet me rezultatin përfundimtar dhe me pikët për çdo seksion të tezës. Fletët e provimit ruhen në departament për 1 vit pas përfundimit të provimeve. Çdo departament përcakton vetë rregullat e arkivimit të fletëve të provimit dhe procesverbaleve.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në <b>Nenin 50</b> dhe <b>51</b> të Rregullores së Përgjithshme të UT-së, studentit ka të drejtë të ankohet për procedurën dhe rregullat e zhvillimit të provimit si dhe për rezultatin përfundimtar të provimit, brenda 48 orëve me anë të një ankese me shkrim drejtuar përgjegjësit të departamentit, i cili ndjek procedurën e ankesës dhe bën verifikimet e duhura për t'i dhënë zgjidhje ankesës. Me urdhër të Dekanit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit, ngrihet një komision ad-hoc, i cili kryen verifikimet e nevojshme kundrejt pretendimeve të studentit/ëve. Pas</p>



	këtyre hapave, me miratim të dekanit komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit ka për qëllim të formojë specialist në fushën e Gjuhësisë dhe Përkthimit, të denjë në tregun e punës. Programi i studimit synon të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Referuar:</p> <p><i>Rregullore e UT-së</i>  <i>Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Programet mësimore 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021</i>  <i>Raportet vjetore për veprimtaritë e kryera 2020-2021</i>  <i>Rregullore e programit të studimit</i>  <i>Raporti vjetor 2019-2020</i>  <i>Raporti vjetor 2018-2019 i Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike</i>  <i>Megjithatë, GVJ mendon se plani mësimor mund të rishihet në mënyrë të tillë që t'i lihet më shumë hapësirë lëndëve praktike që synojnë vënien në përdorim të njohurive gjuhësore në gjuhën ruse dhe që përforcojnë kompetencat e nevojshme profesionale dhe shkencore.</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Programi i ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Gjuhë Ruse”, synon të zhvillojë aftësitë në fushën e letërsisë, gjuhës, qytetërimit, histories ruse, përkthimit dhe interpretimit. Programi ofrohet në gjuhën ruse dhe ka materiale mbështetëse në gjuhën shqipe. Planu mësimor nuk reflekton lëndë të teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>(në përputhje me VKM nr.41, dt. 24.01.2018).</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>Gjatë prezantimit të syllabuseve të çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë rezultatet e të nxëniet që marrin në çdo lëndë të programit të studimit. Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga student në lëndë mund të evidentohen përmes vlerësimit të studentit në gjithë treguesit që përmban ky vlerësim.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	<p>Në takimin e zhvilluar në institucion me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, na u komunikua se në fund të lëndës apo modulit, pedagogu trajton çështjet dhe konceptet më të rëndësishme të diskutuara dhe ato shqyrtohen apo përmbledhen përsëri.</p>



<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik ka realizuar orë mësimore të hapura si dhe seminare me tematika. Kjo evidentohet në aktivitetet e pasqyruara në evidencën 3.5. Aktivitetet me natyrë ekstrakurrikulare, orë të hapura me lektorë të ftuar, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve i vijnë në ndihmë rritjes së cilësisë në këtë program studimi.			
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në programet e lëndëve, përveç elementeve të tilla si numri i krediteve, semestri kur zhvillohet, literatura, etj përcaktohen edhe kompetencat që duhen arritur apo përforcuar. Një pjesë e tyre zhvillohen në orët laboratorike, ndërsa një pjesë e lëndëve, kryesisht ato me natyrë pedagogjike, i paraprijnë praktikës profesionale.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Nga takimi në institucion me pedagogët e angazhur në programin e studimit u konstatua se ata përfshihen në diskutime, kryesisht gjatë takimeve në department, lidhur me problematika që mund të lindin gjatë zhvillimit të procesit të realizimit të procesit mësimor.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga takimi në institucion me përfaqësuesit e degës si dhe studentët, këta të fundit konfirmuan se nxiten të marrin pjesë në aktivitete shkencore të organizuara në institucion, si për shembull konferenca shkencore, trajnime, etj si dhe të botojnë punimet e tyre në revistën e institucionit.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga takimi me studentët në institucion, u konstatua se Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike inkurajon studentët në studime të avancuara kërkimore dhe u theksua se për mbështetjen financiare për ta duhet të ketë një angazhim më konkret në këtë drejtim.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Ekzistojnë një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore, <i>por duhet të ketë angazhim më të madh për të rritur mobilitetin e studentëve pasi nga takimi me ta në institucion rezultoi se nuk ka pasur një nivel të lartë mobiliteti.</i> <i>GVJ rekomandon rritjen e nivelit të bashkëpunimit real me institucione arsimore jashtë vendit dhe shkëmbimeve studentore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e	Gjatë takimit në institucion na u shpjegua se studentët me mesatare mbi 8.5 kanë të drejtë të zgjedhin nëse dëshirojnë të diplomohen me provim formimi ose temë diplome. Në rastin e provimit të diplomimit

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 34



<p>diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>përzgjidhen lëndë nga të tre vitet e studimit dhe u vihen në dijeni paraprakisht studentëve.  <i>GVJ konstatoi se modeli i punimit të diplomës duhet ribërë, sepse nuk është përpiluar me të gjitha udhëzimet përkatëse.</i>  <i>Referuar:</i>  <b><i>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</i></b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët u informuam se stafi akademik organizon në fund të semestrit të dytë të vitit të tretë konsultimet e nevojshme për lëndët që përfshihen në provimin e e formimit. Ndërkohë, pedagogët udhëheqës orientojnë dhe udhëzojnë studentët në realizimin dhe mbrojtjen e temës së diplomës (nëse ka interes).  <i>Referuar:</i>  <b><i>Rregullore e UT-së</i></b>  <b><i>Rregullore e programit të studimit</i></b>  <b><i>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, provimi final organizohet nga një komision i ngritur nga departamenti dhe i miratuar nga dekani i njësisë kryesore për realizimin e provimit final. Komisioni është i përbërë nga tre ose pesë anëtarë të stafit akademik, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Sipas rregullores së programit të studimit, por edhe pas takimit me studentët dhe stafin akademik, rezultojnë se në testimin final përfshihen lëndë të një rëndësie të veçantë të zhvilluara gjatë programit të studimit.  <i>Referuar:</i>  <b><i>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Nga takimet e realizuar me personelin akademik dhe studentët rezultojnë se pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të diplomës.  <i>Referuar:</i>  <b><i>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</i></b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni, në varësi të temave/ provimeve, jep asistencën e mundshme në shërbim të realizimit me sukses të temave të diplomës.  <i>Referuar:</i>  <b><i>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</i></b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi</p>	<p><i>GVJ konstatoi se kjo praktikë ka kohë që nuk aplikohet.</i></p>



është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.				
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në bazë të udhëzimit për përgatitjen dhe realizimin e provimit në programin e ciklit të parë të studimit Bachelor në "Gjuhë Ruse", në përfundim të provimit studenti vlerësohet me notë. <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë. Gjithashtu, ai pajiset edhe me suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 2.5 Suplementi i Studentit</b> <b>Evidencë 3.3 Rregullore diplomimi e programeve studimore të ciklit bachelor</b>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studenti gëzon të drejtën të pajiset me programin e plotë të studimeve të zhvilluara përgjatë tri viteve akademike të ndjekjes së programit të studimit. <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 2.5 Suplementi i Studentit</b>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Gjatë vizitës në institucion, më konkretisht gjatë takimit me punonjëset e sekretarisë mësimore, konstatuam se informacioni për studentët e diplomuar ruhet në arkivat e sekretarisë mësimore. <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 3.2. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR  
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Neni nr 21, i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar dhe Ligjit për Arsimin e Lartë, 80/2015 për referuar përshkrimin dhe detyrave të punës së personelit ndihmës dhe bisedës, u konfirmua se, Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për sigurimin zbatimin e politikave të menaxhimit me efektivitet të burimeve njerëzore. Konkretisht, sektori i burimeve njerëzore merret me procedurat e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme</p> <p>2. Krijimin, plotësimin, përditësimin dhe përshkrimin e mangësive të e dosjes personale të personelit akademik dhe personelit ndihmës.</p> <p>3. Përgatit shkresa të ndryshme, protokollon, raporton, zbaton <b>vendimet e Senatit.</b></p> <p>4. Plotëson regjistrin themeltar.</p> <p>5 Mban evidencën për ngarkesën e stafit mësimor për çdo semestër.</p> <p><i>Referuar: Evidencë 4.1. Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore. pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Dokumentacionit zbaton një procedurë rekrutimi për personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme sipas kërkesave të përcjella nga dekanët dhe nga Rektori, konformon statutit, rregullores, nevojave të departamentit dhe akteve të tjere të brendshme. Hapi i parë është nxjerrja e njoftimit online me të gjitha kriteret e përcaktuara. Gjatë takimit me stafin e zyrës së burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi me sondazh dosje të personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Dosja e stafit akademik përmban:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dokumentacionin që ka dorëzuar në momentin e aplikimit.</li> <li>2. Librezën e punës</li> <li>3. CV</li> <li>4. Listë notash, Diplomë, Diplomë gjuhe të huaj, dëshmi penaliteti, raport mjeko ligjor</li> <li>5. Fotokopje ID</li> <li>6. Procedurën e punësimit</li> <li>7. Vlerësimin e fazës së konkursit</li> </ol> <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga UV (<i>Evidencë 1.1 Statuti i IAL-së</i>) dhe kodit të punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e</p>	<p>Bazuar në statutin e UT dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kriteret për rekrutimin e personelit. Parashikimet për staf të ri bëhen për çdo vit akademik nga departamenti. Çdo vit departamentet bëjnë përcaktimin e stafit akademik që përfshihet në programin e studimit,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 37



akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	ngarkesën mësimore sipas semestrave dhe vjetore. Në bazë të ngarkesës mësimore departamenti bën planifikimin e pedagogëve si dhe i paraqet dekanatit nëse ka nevoja për rekrutim të stafit akademik dhe jo akademik të nevojshme për realizimin e programit të studimit. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjell në rektorat dhe pas rektoratit ato kalojnë për miratim në senat. Pasi miratohen në senat vendet e lira të punës shpallen në faqen e WEB-it të universitetit ku publikohen kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës si dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidat, afatet kohore për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm si dhe tabela e pikëzimit. Dorëzimi i dokumentacionit bëhet me rrugë postare. <b>Evidenca 4.1 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore ose pjesë nga rregullorja e fakultetit.pdf.</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Kriteret për rekrutimin e stafit akademik përcaktohen nga departamenti përgjegjës në bazë të nevojave specifike dhe i përcillen zyrës së burimeve njerëzore. Pas shpalljes së vëndit vakant, dekani ngre komision “ad hoc” që do të realizoj procedurën për rekrutimin e stafit akademik. Konkurrimi kalon në dy faza: 1. Vlerësim në bazë të dosjes 2. Intervista gojore Kur një dosje skualifikohet, Drejtorja e Burimeve Njerëzore lajmëron kandidatin dhe ai brenda afatit kohor prej 5 ditë duhet të bëjë ankimim me shkrim nëse ka. Për çdo fazë vlerësimi pritët 5 ditë pas shpalljes së vlerësimit për ankimime nëse ka. Nëse nuk ka ankimim, mbyllet procedura e vlerësimit dhe vendimi i komisioni i përcillet dekanit. <b>Evidenca 4.1 Rregullore e zyrës së burimeve njerëzore ose pjesë nga rregullorja e fakultetit.pdf</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Sallat e leksioneve, ambienti i departamentit kishin infrastrukturë të përshtatshme (hapsira, kompjutera, tri salla të shfrytëzueshme të bibliotekës, hapësira e sekretarisë), të cilat grupi ynë i pa të gjitha gjatë vizitës në institucion. Zyrat e stafit janë të paisura me tavolin pune, kompjutera personal, printera, fotokopje etj si dhe materile kancelarie për kryerjen e procesit mësimor. Sekretaria ka ambiente të bollshme dhe bashkëkohore për pritjen e studentëve dhe kryerjen e detyrave të saj funksionale. Institucioni ka ambiente të dedikuara për arkivën. Referuar: <b>Evidencë 3.8, Evidencë 4.4. Të dhëna mbi infrastruktuën.pdf</b>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me personelin, u informuam rreth angazhimit të institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm, vihet edhe për stafin e punësuar me kohë të plotë është zgjedhur si formë kualifikimi, mentorimi. Tipike janë trajnime afatshkurtra si dhe trajnime për hartim projektesh. <i>GVJ konstatoi këtë informacion në takimin me personelin, por asnjë nga këto informacione nuk ishte i dokumentuar.</i></p> <p><b>Referuar:</b> <b><i>Evidencë 2.9 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.pdf</i></b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies duke filluar nga trajnimet afatshkurtra pjesëmrrje në konferencat shkencore, dhe botimi i një artikulli në një revistë shkencore gjatë një viti akademik. 1 artikull shkencor në vit, siç na u tha në takimin me stafin akademik i vendosur me vendim Senati, për anëtarët e stafit akademik na u duk një kriter shumë minimal për nxitjen e punës shkencore. Orientimi drejt shkembimit të eksperincave ndërkombëtare me anë të bursave Erasmus është ndihmuese në kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjatë konsultimit me dokumentacionin në rang institucioni ishin hartuar disa projekte bashkëpunimi me universitete jashtë kufijve, por stafi akademik i këtij programi studimi nuk ishte i përfshirë ende. <i>Gjatë takimit në institucion u informuam për pjesëmarrje të stafit akademik të këtij program në shumë projekte por asnjë pjemarrje nuk ishte e dokumentuar.</i></p> <p><b><i>Evidencë 2.9 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.pdf</i></b> <b><i>Evidenca 3.9.4 Revista e FGJH-së.pdf</i></b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni bën përpjekje për tërheqjen e një stafi akademik të kualifikuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore me sektorët përkatës që janë përfshirë në këtë program studimi janë mbështetëse dhe të mjaftueshme. Ka një ndarje të përgjegjësive dhe të detyrave dhe njëkohësisht gadishmëri për realizimin e objektivave të caktuar.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve</p>	<p>Institucioni ka siguruar hapësira të mjaftueshme në mjedise të përshtatshme referuar numrit të sallave të leksioneve, numrit të sallave të seminareve, objektet bazike, dërrasa, tavolina, karrige GVJ i preku gjatë vizitës në institucion. Nisur dhe nga profili i programit dhe numri i studentëve, këto ambiente konsiderohen të përshtatshme.</p>



mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.									
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ka investuar në aparatura të nevojshme për procesin e mësimdhënies. <i>Referuar (Evidencës.3.8 Të dhëna për infrastukturën pdf,)</i> Plani i masave për rritjen cilësisë së programit kishte si një ndër rekomandimet thelbësore përmirësimi i kushteve për studentët që zhvillojnë mësim. Gjatë vizitës u konstatua se infrastruktura e institucionit ishte me kushte të përshtatshme dhe cilësore për të kryer procesin mësimor. Institucioni e konsideron efektive, gërshtimin e mësimdhënies tradicionale të kombinuar me metodën teknologjike. Zyra e departamentit dispononte videoprojektorë dhe laptop:								
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Siç e referuam dhe më sipër në përshtatje dhe me natyrën e këtij program studimi departamenti kishte në dispozicion 2 laboratorë, laptop, video projektorë, printer.  Referuar: <i>Evidencës.3.8 Të dhëna për infrastukturën pdf</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Departamenti në raportin e vlerësimit të brendshëm përcjell informacionin se institucioni parashikon në buxhetin e tij ndërtimin e laboratoreve, ky plan është konkretizuar. Departamenti kishte laboratorë funksionale me pajisje cilësore. Referuar: <i>3.5.3 Raporti i veprimtarisë mesimore kërkimore-shkencore per vitin 2020-2021-29112016114930.pdf</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<i>Institucioni nuk parashikon praktika profesionale në ciklin e parë, por vetëm në ciklin e dytë.</i>  <i>GVJ e konstaton si hapësirë që është e nevojshme të plotësoshet. Do të ndihmonte që studentët të kishin lidhje konkrete për të praktikuar njohurit e marra dhe një mundësi këshillimi karriere për zgjedhur drejt programin e ciklit të dytë të studimeve.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka tri godina biblioteke. Dy prej tyre punojnë me orar 8.00-16.00 dhe njëra prej tyre me orar të zgjatur. Biblioteka ka mjedise me kushte komode dhe hapësira, tavolina, karrige, mjete fizike, wi – fi, ambiente që mund të shfrytëzohen lirshëm nga studentët dhe personeli akademik</p> <p><i>Evidencë 3.9.5 Rregullore e brendshme e bibliotekës së FGJH-së.pdf.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me një numër të konsiderueshëm tekste në gjuhë të huaj. Gjithsesi në raportin e brendshëm inventari dhe lista e librave e pasqyruar në evidenca nuk identifikohet asnjë titull i shtuar nga për programin e gjuhës ruse</p> <p>Referuar:</p> <p><i>Evidencë 3.9.2. Listë librash 3.9.2. 2019 – 2021, pdf</i></p> <p>Gjatë vizitës u vu re një numër librash bazë të gjuhësisë të domsdoshëm për këtë program. <i>Ndoshta institucioni duhet të përditësojë dhe pasurojë bibliotekën me tituj cilësorë e të rinj në ndihmë të studentëve, ose nga buxheti i programuar të ofrojë abonim në revista shkencore ose në biblioteka digjitale të univeriteteve të njohura që kanë të njëjtin program studimi, të cilat ofrojnë kundrejt pagesë studime cilësore. Do të ndihmonte në grishjen e studentëve për një qasje me reflektive.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në bashkëpunim me MASR ka vënë në dispozicion librarinë online JSTOR.</p> <p>Referuar:</p> <p><i>Evidencë 3.9.1.pdf</i></p> <p>Aksesi në këtë librari është si për studentët dhe për personelin akademik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Institucioni ka bërë përpjekje për të investuar në infrastrukture. Të tri godinat kanë një numër të përcaktuar kompjuterash dhe pajisjesh. Interneti pa limit dhe shtimi i numrit të kompjuterave ndihmon studentët për ta bërë më të aksesueshëm gjithë informacionin që mund të merret në JSTOR ose informacione të tjera.</p> <p><i>3.9.1 JSTOR.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka një plan për të pasuruar dhe përditësuar titujt e bibliotekës. Siç vihet re nga informacionet e RVB-së, ky plan lidhet me degët e tjera, por nuk ka asnjë titull të shtuar në programin gjuhës ruse.</p> <p>Referuar:</p> <p><i>Evidence 3.9.2. 3.9.3. Liste librash dhe liste librash të shtuar.pdf</i></p> <p><i>Procedurat që ndiqen për pasurimin e fondit lidhur me këtë program janë të paqarta.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Të tri hapësirat që shërbejnë si bibliotekë qëndrojnë të hapura gjatë ditëve të javës në përputhje me procesin mësimor. Dy me orar 08- 16.00 dhe 08- 20.00</p> <p>Orari është i përshtatshëm për t'u shfrytëzuar nga studentët dhe nga personeli akademik.</p> <p><i>3.9.5 Rregullore e brendshme e bibliotekës së FGJH-së.pdf</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi i menaxhimit administrohet gjithë informacionin që lidhet me studentët. Ai disponon të tre llojet e regjistrave në formë shkresore dhe elektronike, dosjet e regjistrimit dhe diplomimit, dhe gjithë procesverbalet e rezultateve të studentëve. Të dhënat janë të hedhura në platformën Microsoft teams duke ndihmuar studentët të kenë akses për një numër informacionesh. <i>Evidencë 3.10.4 Microsoft office 365 për student.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Siç cituam më sipër, institucioni ka një sistem të brendshëm menaxhimi elektronik i cili ende ka aksesuar administrimin e të dhënave të stafit akademik dhe të personelit ndihmës. Gjithsesi sektori i burimeve njerëzore dhe i kurrikulave kryen të gjithë procedurat përkatëse për çdo punonjës të stafit akademik, personelit ndihmës, dhe disponon dosje personale me përditësimin e çdo informacioni. <i>Evidencë 3.10.5 Microsoft office 365 TEAMS.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi MS siguron akses dhe është i dedikuar për të mundësuar shërbime për të gjithë personat e autorizuar që kanë një llogari personale të universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e UT bazuar në Ligjin “Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. <i>Evidencë 3.10.3 Manual sistemi e-student (Microsoft Teams).pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Secili pedagog mund të shpërndajë leksione dhe informacione shtesë në sistem MS për studentët e tij dhe ndërkohë ata mund të përcjellin dhe mendimin e tyre rreth leksionit duke ruajtur anonimat. Sistemi i menaxhimit të integruar MS shkon dhe në ndihmë të shkresave zyrtare që sekretaritë mësimore duhet t’u shpërndajnë studentëve <i>Evidencë 3.10.1 E-student pedagog -manual përdorimi.pdf</i>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të	Sistemi garanton monitorimin në kohë reale të aktiviteteve akademike, mundëson raporte individuale. Sipas nevojave sistemi ndihmon aksesimin e të dhënave, tarifivae afatet e e hedhjes së vlerësimeve. <i>Evidencë 3.12 Mbi rregulloren e procedurës online të provimeve të sezonit të dimrit.pdf</i>



dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.									
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja e Web e universitetit publikon të gjitha informacionet zyrtare që lidhen me programin studimit duke ndjekur politikat institucionale. Të gjithë informacionet publikohen në të dyja gjuhë, referuar <i>Evidencë 2.10 Politikat institucionale të publikimit të informacionit (udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e ial në web; etj).pdf</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Niveli i përmbushjes</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga takimi u konfirmua se institucioni harton një raport financiar që pasqyron koston financiare mesatare për çdo student në nivel universitetit. Fillesa e raportit nis nga njësia bazë që është departamenti <i>Referuar: Evidencë 4.5 Përgatitja e buxhetit 4.5.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Në përputhje me strukturën e buxhetit, institucioni ndjek të dy fazat e hartimit të buxheti. Ai që vihet në dispozicion nga granti i pakushtëzuar i MASR -i, buxheti i shtetit dhe nga buxheti i i universitetit. Hartimi i buxhetit nis nga njësia bazë e cila llogarit të gjitha shpenzimet për këtë program studimi dhe më tej koordinohen në nivel fakultetit dhe me strukturata e tjera. Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse mbledh të dhënat nga shërbimet mbështetëse dhe paraqet planin për vitin në perspektive duke e paraqitur tek Rektorati, Senati akademik. <i>Referuar: Evidence 4.5 Përgatitja e buxhetit 4.5.pdf Evidencë 4.5.1 Miratimi i grantit të buxhetit të mësimdhënies nga buxheti i shtetit 2019. pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	Universitetit I Tiranës i nënshtrohet auditit të jashëm Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR-së dhe auditit të brendshëm, një sektor më vete, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe me vendimin e Senatit



<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Akademik. Auditi i brendshëm harton një raport periodik financiar të të ardhurave nga tarifat apo burimet e tjera. Administratori e paraqet këtë raport në Senatën Akademikë i cili miratohet dhe protokollohet.</p> <p><i>Referuar:</i> <b>Evidencë 4.5.3 Përcjellja e raportit përfundimtar të auditimit bazuar në planin vjetor 2020</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni merr në analizë gjendjen financiare. Kjo bëhet jo vetëm për periudhën njëvjeçare por merr përsipër të kryejë krahasime dhe të bëjë ndërhyrje dhe reflektime për secilin program.</p> <p><b>GVJ konstaton se një studim i ri mirëfilli i tregut të punës dhe pritshmërive do të ndihmonte dhe për një financim cilësor të këtij programi</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare duke u nisur nga dy burimet financiare: Grantet e MASR -së Fondet që sigurohen nga të ardhurat e universitetit. Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare. Pasqyra financiare hartohet brenda afateve të përcaktuara. <b>4.5.2 Pasqyrat financiare të vitit 2019. pdf</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Të gjitha procedurat e pranimit, vazhdimet të programit të studimit dhe diplomimit janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, me aktet ligjore në fuqi, udhëzimet e MASR-së dhe rregulloren e brendshme të institucionit, rregullores së departamentit duke filluar nga kriteri i mesatares në hyrje të programit kohëzgjatjen zyrtare dhe shumën e krediteve në fund të programit.</p> <p><i>Referuar:</i>  <b>Evidencë 1.3. Rrregullore e IAL.pdf</b>  <b>Evidencë 2.2.2.1.2</b>  <b>Rregullore e njësive bazë.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar Statutit të IAL-së (<i>Evidencë 1.1. pdf</i>) e cila mbështet parimin e barazisë dhe mosdiskriminit, garantohet transparencë për kriteret hyrëse dhe të gjitha procedurat e nevojshme për çdo student duke përfshirë dhe transferimin e krediteve (<i>Evidencë 5.10. Kriteret e pranimit, pdf</i>). Kandidati ndjek të gjitha hapat që i nevojiten kundrejt afateve ligjore të përcaktuara Numri i studentëve ndahet sipas zërave të përcaktuar më parë. Departamenti mbron studentët ndaj çdo lloj diskriminimi apo kriterëve të papërshtatshme. <i>Referuar:</i>  <b>(Evidencë 1.1 Strategjia e zhvillimit të degës së Gjuhës Ruse. pdf)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë ka kriteret të pranimit të studentëve dhe transferimi të studimeve të paraqitura në Statut. Departamenti ka ngritur “Komisionin për ekuivalentimin e lëndëve” i cili në bashkëpunim me sekretarinë mësimore merret me të gjitha procedurat përkatëse.</p> <p><i>Referuar:</i>  <b>Evidencë 1.1. Statuti i IAL- së</b>  <b>Evidencë 5.7 Udhërrëfyesin e Studentit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni miraton në Senatin Akademik të gjitha kriteret hyrëse në një program studimi. Referuar Udhëzimit të MASR-së, për kuota dhe kriteret, aplikantët duhet të kenë përfunduar AML-në në shtetin shqiptar apo jashtë, pormë parë studentët që kanë përfunduar jashtë duhet të kryejnë njohjen dhe njësimin e diplomës së fituar pranë institucionit përkatës dhe të keni plotësuar kriterin e mesatares. (<b>Evidencë 5.10. Kriteret e pranimit. pdf</b>). Të gjitha këto informacione publikohen në faqen zyrtare të web -it të universitetit dhe janë trasnparente.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të</p>	<p>Të gjitha kriteret e pranimit në këtë program studimi janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë nr 80/2015 dhe VKM – së për përcaktimin e notës mesatare, Udhëzimin e MASR-së, kriteret e maturës shtetërore. Institucioni parashikon kuota të veçanta për studentët e trojeve dhe</p>



ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	studentët e huaj nga programi Erasmus, por deri tani nuk kemi konstatuar asnjë rast të Erasmus në programin e ciklit të parë. Referuar ( <i>Evidencë 1.7. Marrëveshjet ERASMUS+.pdf</i> ) <i>GVJ rekomandon mundësisë së shkëmbimit të studentëve edhe gjatë ciklit të parë të studimeve. Kjo mundësi do të ndihmonte në grishjen e studentëve për të aplikuar edhe në ciklin e parë të studimeve.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzoi publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjatë takimit në institucion u informuam se departamenti gjatë akademik harton dhe realizon takime promovuese nëpër panaire, organizon ditët e hapura. <i>Gjithsesi vendosja e mesatares për këtë program studimi ka ndikuar ndjeshëm në numrin e nxënësve të cilët duan të ndjekin këtë program studimi. (Evidencë 2.4 Rregullore e këshillimit të zyrës së karrierës.pdf</i> <i>GVJ rekomandon se departamenti e ka të nevojshme të përditësojë format e promovimit apo të motivimit të studentëve për të ofruar studentë në këtë program.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë takimit të zhvilluar në ambientet e fakultetit dhe duke u konsultuar me dokumentacionin e paraqitur, në takimin me studentët dhe në rregulloren e miratuar të institucionit, GVJ konstaton që institucioni përcjell dhe jep informacionin e nevojshëm për të ndihmuar studentin për të ndihmuar përparimin e tyre Çdo individ që fiton statusin e studentit pajiset me adresën elektronike, kodin unik në sistem, akses për të parë kontrollin e vlerësimit për çdo lëndë dhe përditësimin me çdo informacion të nevojshëm. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan dhe koordinatori i studentëve dhe përgjegjësi i departamentit të cilët ofrojnë informacion të nevojshëm për çdo shqetësim apo problematikë <i>Referuar:</i> <i>Evidencë 2.8. Vendim për emërimin e koordinorit pdf.</i> <i>GVJ informon se nuk pati mundësi të takoj studentë të ciklit të parë të këtij programi por vetëm dy studente të cilat kishin përfunduar ciklin e dytë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Siç parashikohet dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/ 2015 institucioni aplikon me korrektësi procedurat për njohjen e krediteve dhe studimeve të mëparshme. Procedurat nisin pas kërkesës së studentit dhe plotësimi të formularit. Informacionet i identifikuam në Rregulloren e Universitetit <i>Referuar: Evidencë 2.3.4 Rregullore e FGJH pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve	Institucioni ka një zyrë të veçantë informimi për studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Siç u konstatua të gjitha syllabuset kanë të detajuar të gjithë infomacionin duke nisur nga

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 46



<p>e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>ngarkesa, temat mësimore, literatura për çdo temë, frekuentimi dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Gjatë takimit me stafin e profesorëve u infomua. Çdo pedagog, në fund të sylabusit të çdo lënde vendos edhe mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të studentëve, të cilat iu bëhen me dije atyre që në fillim të procesit mësimor, <i>por nëse kjo procedurë praktikohej ishte jo e mundur për tu vërtetuar. Asnjë student i këtij programi nuk ishte i përfshirë në pyetësorin e organizuar dhe ky program nuk ka pasur asnjë student të regjistruar prej tri viteve. GVJ nuk identifikoi asnjë syllabus në dokumentacionet e ngarkuara.</i> <b>Referuar: Evidencë 2.4. Rregullore këshillimit së zyrës së karrierës pdf</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e Universitetit parashikon qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomes për programin Bachelor. Gjithë procedura është mbështetur në nenet dhe rregulloren përkatëse të miratuar nga Senati Akademik. Nga stafi akademik na u bë e ditur modeli i provimit përfundimtar. Të gjithë studentët i nështrohen provimit dhe nuk marrin temë diplome. <i>GVJ nuk kishte mundësi të pyeste studentët lidhur me efektshmërinë dhe cilësinë e kontrollit të dijeve të këtij provimi. GVJ rekomandon që në të ardhmen ta shohi me prioritet punën me studentët për hartimin e një punimi diplomënë përfundim të ciklit të parë dhe pasurimit të formës së testimit të studentevë.</i> <b>Referuar: Evidence 5.3. Modeli i punimit të diplomës pdf.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Sektori i Komunikimit është hallkë kryesore e Drejtorise së Burimeve Njerëzore që merret me organizimin e takimeve të hapura, për ti motivuar matruarantët që të zgjedhin këtë program studimi. Organizimi i panairëve është një mekanizëm tjetër i përzgjedhur për informim. <b>Evidencë 2.10 Politikat institucionale të publikimit të informacionit (udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e ial në web; etj).pdf</b> Gjithsesi shqetësimi i shprehur dhe nga stafi akademik është mungesa e numrit të studentëve që ndjekin këtë program studimi, kjo për shumë arsye objektive. Ky shqetësim na u paraqit dhe nga Dekania e këtij Fakulteti. <i>GVJ rekomandons se politika e institucioni ka në thelb promovimin dhe reklamimin e këtij programi, mund të pasurohet dhe me një vizitë nëpër gjimnaze të pedagoqeve dhe studentëve me të spikatur për t'i motivuar të zgjedhin këtë degë. Studimi i thelluar i tregut të punës. Përfshirja e studentëve të ciklit të parë në programin Erasmus+ dhe mundësisë së ekperincës së jë viti akademik në një nga universitet ruse me të cilat ky program ka marrëveshje mund të joshte maturantet për të frekue ntuar këtë program.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p><b>Standardi V.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni përpiqet të informoje në mënyrë të hollësishme për strukturën dhe organizimin e programit të studimit. Faqja zyrtare web e universitetit përcjell të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo student duke filluar nga rregullorja, oragnizimi dhe kohëzgjatja. Gjithashtu këkohet koordinim të punës së përgjegjësit të departamentit dhe sekretarisë mësimore përkatëse me zyrën e studentit për takime informuese. Koordinator i studentëve luan rol thelbësor në informimin e studentëve. <i>(Evidencë 2.8.2 Detyre e Koordinatorit.pdf)</i> <b>GVJ konstaton se mungesa e studentëve e bën të pamundur që ky informacion të mund të vertetohej në impaktin që ka pasur te stundetët</b></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se informacioni i nevojshëm për programin, procesin, rregulloren dhe aktivitet ofrohet për studentët edhe në llogaritë e tyre elektronike, apo në format të printuar të vendosur në mjediset e hapura të universiteti. Siç referuam dhe më sipër studentit informohet me detaje dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse. <i>(Evidenca 2.10 Politikat institucionale të publikimit të informacionit (udhëzues të posaçëm; takime të hapura; faqja e ial në web; etj).pdf)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Alumni, Zyra e Këshillimit dhe stafi akademik janë si urë lidhëse për orientimin e tregut të punës. <i>(Evidenca 2.4 Rregullore e këshillimit të zyrës së karrierës.pdf)</i> <i>Gjithsesi, nuk ka ndonjë informacion konkret sesi kanë ndikuar në punësim e studentëve, apo ndonjë studim konkret për këte urë lidhëse. Orientimi profesional mund të ishte më i saktë, nëse do të kishin një studim të tregut të punës dhe më pas të ndërtohej bashkëpunimi me tyre. GVJ konstaton se mungesa e studentëve në këtë program është tregues për nevojën e një pune më eficente të kësaj zyre këshillimi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sistemi krijon mundësi informacioni të hollësishëm për studentët. Që në momentin e parë ata pajisen me username/ fjalëkalim duke përfutur dhe akses për leksionet dhe informacion shtesë infromacionet. Gjithashtu rol në informimin e studentëve kanë dhe stendat informuese në hapësirat e veçanta të universitetit të cilat u vizituan nga GVJ. <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 3.10.1.E student - pedagog manual perdorimi.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit u ofron mundësi aksesimi shumë të lehtë studentëve duke u dhënë mundësi informacioni dhe në distancë. Faqja zyrtare e web dhe llogaritë zyrtare në rrjetet sociale të universiteti janë një nga format e përditësimit të informacionit në kohë reale. <b>)Evidencë 3.12 Mbi rregulloren e procedurës online të provimeve të sezonit të dimrit.pdf)</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	



<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni i Arsimit të lartë disponon të dhëna dhe statistika për numrin e studentëve. Këto të dhëna janë të ruajtuara në të tri format hard copy të regjistrave dhe regjistrin në formë elektronike. Në sekretarinë mësimore ishin të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. Sekretaria kishte: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrin themeltar të studentëve</li> <li>- Regjistrin e lëshimit të diplomave</li> <li>- Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave)</li> </ul> Në takimin me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen në arkivën e shtetit. <i>Evidencë 5.4 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje - Copy.pdf</i> <i>Referuar Evidencë 5.8 Urdhër i përbashkët QSHA-QNRASH, 02.07.2020, ndryshuar më 06.08.2020, 30.09.2020 dhe 07.12.2020.pdf</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se institucioni ka të gjitha statistikat vjetore për studentet, si në kualifikimin dhe regjistrimin tërheqjet, largimet e mundshme e deri në cilësinë e diplomimit.  <i>GVJ duke iu referuar numri të regjistrimit të studentëve vihet re, rënie e theksuar e regjistrimit të tyre. Numri i studentëve ka luhatur të konsiderueshme nga viti i tretë në vitin e parë. Konkretisht deri në momentin që është kryer vizita në vitin e parë të Bachelorit nuk kishte të regjistruar asnjë studentë.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Gjatë vizitës GVJ konstatoi se institucioni ruante të gjitha informacionet e ecurisë së studentit nga momenti i regjistrimit deri në lëshimin e diplomave i cili realizohet në formën hard copy dhe në regjistrin elektronik. Bazuar në nenet përkatëse të Statutit të Universitetit Të dhënat e studentëve sigurohen dhe ruhen në bazë të parimit të konfidencialitetit. <i>Referuar: Evidencë 1.1. Statuti i IAL. pdf</i>
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Informacioni statistikor ruhet në systemin E - student dhe secili pre studentëve ka një dosje në këtë sistem por, studenti humb të drejtën e aksesimit menjëherë pasi përfundon programin e studimit. <i>Referuar dhe praktikave të universiteteve europiane, emaili dhe fjalëkalimi janë përherë të aksesueshëm dhe një student mund të tërheqë elektronikisht listën e notave në sistemin elektronik kundrejt një pagese.</i> <i>Referuar: Evidencë 3.10.2. Manuali e- student pdf</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje	Referuar Udhëzimit nr.5 të MASR-së, institucioni bën raport vjetor analitik për profilit dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të një programi. <i>Sjellim në vëmendje që rritja e kufirit të mesatares ka</i>



dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p><i>ulur ndjeshëm numrin e pranimeve. Vlen të përmendet fakti që ky program studimi nuk ka prej dy vitesh studentët të regjistruar për të vazhduar këtë cikël studimi. Ky informacion sjell nevojën e një studimi më të hollësishëm të tregut të punës dhe bashkëpunimi me shkollat, institucionet bizneset. Do të ishte një masë ndihmuese dhe do të shërbente për një raport të plotë periodik për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve nga ky program studimi.</i></p> <p>Referuar:  <i>Evidencë 1.8. Raporti vjetor 2018- 2019 pdf, Evidencë 1.8.1 Raporti vjetor 2020- 2021pdf:</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Aktet nënligjore të Ligjit të Arsimit të Lartë, statusi dhe rregullorja e miratuar kërkon përfshirjen e studentëve në strukturën e Senatit Akademik, Këshillit të Etikës, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni parashikon angazhimin e studentëve me përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve në çdo instancë qeverisëse.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Rregullore e Institucionit të IAL-së .pdf</i>  <i>3.1.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë në IAL.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p><i>Për shkak të mungesës së studentëve GVJ nuk arriti të konfirmojm nga vetë studentët nëse përfaqësohen jo vetëm si emër në proceset vendimmarrëse në organet drejtuese përmes përfaqësuesve të zgjedhur prej tyre.</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Gjatë konsultimit me dokumentacionin u kostatua se institucioni ka në vëmendje përmirësimin e programit të studimit dhe ngarkesën akademike të studentëve. Studentët kanë të drejtë të transferojnë kredite duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike. Përgjegjësi departamentit, koodinatori i studentëve dhe sekretaria mësimore bashkëveprojnë për kryejën e këtij procesi, por më parë studenti duhet të plotësojë një formular aplikimi. Gjithashtu universiteti parashikon edhe një numër të caktuar të studentëve të trojeve dhe studentët që kanë përfunduar studimet e arsimit të mesëm të lartë jashtë kufijve por, me parë duhet të njohin këtë diplomë në institucionin përkatës.</p>



	<b>Evidencë 5.4 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje - Copy.pdf</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Një instrument i përdorur gjerësisht sipas dokumenteve të paraqitura nga universiteti për përmirësimin e cilësisë është pyetësori me studentët. Pyetësi në evidencën përkatëse përkatëse pëmbante 30 pyetje të strukturuar dhe të hapura. Referuar Evidencëve të raportuara për pyetësor dhe bisedave të drejtpërdrejta u vu në dukje se asnjë studentë i këtij programi nuk ishte pjesmarrës në këtë program. Vlen të përmendet që pyetësori nuk është i profilizuar për këtë program studimit por në rang Universiteti Institucioni i reflekton rezultatet në planin e masave për përmirësimin cilësisë <i>Referuar:</i> <b>Evidencë 3.6.3.7. Pyetësi i studentëve për vlerësimin cilësisë në mësimdhënie</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.	<b>Lidhur me këtë pikë, GVJ në bisedë me NJSCB konstatoi se anjë student i këtij programi studimi nuk kishte qenë pjesmarrës në pyetësorin e organizuar.</b>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka si pjesë të strukturës njësitë e posaçme që koordinohen në shërbimin dhe informimin e studentëve sic janë: Drejtoria e Edukimit, Sektori i Kurrikulave, Zyra e Shërbimit të Studentëve dhe Sektori i Këshillimit të Karrierës. Procedurat e ndjekura nga këto njësi janë në përputhje me Statutin dhe rregulloren e përcaktuar nga universiteti. I gjithë informacioni i nevojshëm shpërndahet tek studentët në bashkëveprim me Sekretarinë Mësimore dhe Koordinatorin e Studentëve. Në funksion të informimit të studentëve janë: – Zyra e këshillimit akademik që organizon dhe sistemin e tutoratit për studentët e sapo regjistruar. Këshilltari akademik asiston studentët nga momenti i regjistrimit deri tek këshillimi për mundësinë e ndjekjes së programeve të tjera të studimit (master) apo për mundësitë e punësimit.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sekretaria mësimore është e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim.</li> <li>- Zyra e studentit: informon studentët për systemin e bursave, sistemin e akomodimit</li> </ul> <p><b>Referuar: Evidencë 2.4 Rregullore e keshillimit të zyrës së karrierës.pdf</b></p>								
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Sistemit të sektorëve të cituar më sipër u shtohet edhe zyra e Alumnit, e cila konsiderohet si urë lidhëse midis universiteti dhe tregut të punës. Të gjitha këto hallka kanë në thelb jo vetem informimin dhe këshillimin për programin e studimit por duhet të shërbejnë për orientimin e duhur profesional. <b>GVJ rekomandon se kjo njësi, mund të jetë me aktive në ndihmën e ofruar për studentët për krijimin e një profili më të plotë dhe të qartë profesional, që do t-i ndihmonte në krijimin e shumë mundësive për punësim.</b></p>								
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Institucioni ofron mundësinë e këshillimit të karrierës në zyra e shërbime e cila ndihmon në zhvillimin social dhe kulturor të studentëve potencialë. <i>Zyra e Këshillimit të Karrierës parimisht jep dhe orienton me informacion për karrierën profesionale.</i></p> <p><i>GVJ sjellë në vëmendje, që kjo zyrë mund të krijoj hapësira për lobuar më shumë për këtë program studimi.</i></p> <p><b>Evidencë 2.4 Rregullore e këshillimit të zyrës së karrierës.pdf</b></p>								
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Institucioni ka një zyrë Këshillimi Karriere e cila bashkëpunon dhe koordinon veprimet me hallkat e tjera administrative në rektorat por duhet sjellë në vëmendje që e kishim të pamundur të evidentonim punën e kësaj zyre lidhur me këtë program studimi.</p> <p><b>Evidencë 2.4 Rregullore e këshillimit të zyrës së karrierës.pdf</b></p> <p><i>GVJ konstaton se zyra e Alumnit duhet të ketë si pjesë të përshkrimit të punës jo vetem listimin e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi por edhe këshillimin e studentëve gjatë karrierës së tyre, arrijtet dhe pengesat duke i dhenë mundësi krijimi të Alumnit</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucionit hartoen në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe si detyrim i Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Institucioni ka miratuar një grup pune të përheshëm në nivel institucional, i cili mbështet punën e tij në Planin Stratetgjik dhe në Statusin e institucionit.</p> <p><i>Referuar:</i>  <b>Evidencë 3.1.7. Rregullore për funksionimin e njësive të brendshme të cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.</b>  <b>Evidencë 3.1.8. Urdhër vendim mbi ngritjen NJSCB në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një Njësi të Përhershme të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë duke e përshtatur si sektor në Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe të Projekteve.</p> <p><b>(Evidencë 3.1.8. Urdhër vendim mbi ngritjen NJSCB në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja).</b> Çdo njësi bazë ka një komision të përhershëm cilësie në të cilin ashtu si në çdo organ qeverisës së universiteti ka përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga Keshilli i Studentëve. Si mekanizëm i monitorimit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihen edhe zv/ dekanët që mbulojnë arritjet akdemike dhe përpilimi i raporteve vjetore që fillojnë nga nivel departamenti.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë për Akreditimin Institucional dhe të programeve të studimit. UT ka përmbushur detyrimet ligjore dhe po punon për akreditimin e programeve të studimit.</p> <p>Institucioni i është nënshtruar dhe sondazhit kombëtar të studentëve. Institucioni ka ndjekur të gjitha procedurat e kërkuara të lidhura me këtë proces.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni perpiqet të hartojë një politikë të qartë të sigurimit të brendshëm të cilësisë Në Statutin e universitetit të përshkruhen procedurat që ndiqen duke nisur nga hartimi i rregullores, hartimin e pyetësoreve në funksion të komisioneve dhe autoriteteve dhe studime të gjurmimit të ecurisë së studentëve. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 ka <b>përpiluar rregulloren e NJSBC</b>. Konkretisht departamenti i Gjuhëve Sllave, dhe GVB i programit të Gjuhës Ruse duhet të paraqesin një raport i procedurave për përmirësim dhe ndryshim për ciklin parë dhe të dytë. Ky raport paraqet Drejtorisë së Edukimit e cila e përcjell për shqyrtim dhe vendim Senatit Akademik.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 53



	<i>Referuar: Evidencë 3.1.2. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në IAL.pdf</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	<p>Njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve në Universitetin e Tiranës përbëhet nga Drejtoria e Kurrikulave dhe shërbimit të studentëve, koordinorët që merren me arritjet akademike dhe NJSCVB. Në takimin me personel të Drejtorisë së Edukimit, GVJ u njoh me aspekte praktike të zyrës së kurikulave pranë kësaj drejtorie.</p> <p><i>GVJ rekomandon rishikimin e programeve duke përfshirë riorganizimin në masën 20% dhe përfshijne e praktikës gjatë ciklit të parë të studimit. Në RVB (Evidencë 2.14 identifikohet Rriorganizim e programit por gjatë takimit me stafin dhe konsultimin me RVB u identifikua mospërputhje e përshtimit të dokumentacionit</i></p> <p><b>Referuar:</b> <i>Evidencë 1.2.2. Strategjia e zhvillimit dega e Gjuhës Ruse</i> <i>Evidencë 2.14</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Institucioni përdor mekanizma e procese të dokumentuara si raporte periodike vjetore</p> <p>Ndërsa Drejtoria e Kurrikulave ndjek procedurat dhe vlerëson mundësinë e riorganizimit të programeve. Sipas RVB hartohen pyetësorë i përpara çdo sezoni provimesh duke ruajtur anonimatit e studentëve dhe diskutimi i tyre duke videntuar pikat e dobëta dhe pikat e forta, hartimi i një plani masash për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në Evidencët e paraqitura. f</p> <p>Referuar: <b>Referuar Raportit te viti 2019- 2020, 2020- 2021, Evidencë 1.8. 18.1.</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	<p>Metodologjia e përdorur për pyetësorët e studentëve është sasiore dhe është miratuar me vendim të Senatit Akademik</p> <p>Sipas (<i>Evidencë 3.6 Pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. pdf</i>) pyetësori ka gjithsej 30-të pyetje të strukturuar dhe 4-tër të hapura. <i>GVJ konstaton se në pyetësor janë përfshirë studentët e fakultetit por asnjë prej yzre nuk është student që ka frekuentuar këtë program studimi në ciklin e parë.</i></p> <p>GVJ rekomandon se mungesa e një pyetësori të profilizuar për programin e gjuhës ruse është një hapësirë boshe e cila do të ndihmonete më shumë për vlerësimin objektiv të arritjeve, prtishmëritë dhe mundësitë e plotësimi e përditësimi të këtij programi.</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar procedurës së Analizës së Vlerësimit të pyetësoreve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, raporti i pyetësorëve me rekomandimet dhe reflektimeve u përcillen strukturave përgjegjëse në universitet. Dokumentimi analitik i rezultateve realizohet nga NJSBC. NJSBC përpilon gjithashtu projekt propozimet dhe rekomandimet mbështetur në analizën e pyetësorëve dhe formularëve të performancës. Raporti i dërgohet njësisë kryesore e cila ia përcjell departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p> <p>Referuar( <i>Evidencës 3.1.7 Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.pdf</i> )</p> <p><i>GVJ konstaton se ky program studimi do të reflektojë analizën e pyetësorëve të programeve simotra por jo pikat më të forta apo hapësirat boshe të këtij programi studimi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Njësitë kryesore bazë, departamentet diskutojnë dhe reflektojnë mbi këto raporte Në planin e masave të përmirësimit të cilësisë janë paraqitur pikat e dobëta dhe pikat e forta, njëkohësisht dhe rekomandimet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi VI.3**

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar VKM 531, Manualit, Rregullores, Paketave të sigurimit të cilësisë të Universitetit të Tiranës, Shtojca 3.1.5, VKM,3.1.4 Paketa e instrumentave të cilësisë (Evidencë 3.1.3, Manuali i Sigurimit të cilësisë) Evidencë 3.1.2 Rregullore për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Rektorati ka ngritur pranë Drejtorisë së Edukimit, sektorin e Njësive të Brendshme të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. Hallkë e sigurimit të cilësisë është dhe bashkëpunim aktorët përkatës në fakultete. Më rëndësi është edhe parashikimi për ngritjen e Komisionit të Sigurisë së Cilësisë së Brendshme. Puna e këtij komisioni ka në thelb monitorimin e syllabuseve të programit të studimit dhe raportimin në departament të mundësive të përmirësimit dhe reflektimit. Raporti mund të ndihmojë në reflektimin dhe në rritjen e cilësisë së syllabuseve. ( Evidencës 3.1.7 Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.pdf</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e</p>	<p>Me vendim Rektorati është hartuar një plan strategjik (Evidencë 1.2. Strategjia e UT 2018-2023) i cili përfshin dhe ngritjen e Komitetit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 55



<p>instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Shkencor dhe Koordinatorët, i cili do të duhej të monitoronte punën sesi janë ndërtuar syllabuset, ngarkesën, shpërndarjen e krediteve dhe mbarëvajtjes së formave të vlerësimit. Institucioni përdor tri metoda për kryerjen e procesit të vetëvlerësimit, duke nisur nga raporti vjetor (<i>Evidencë 1.8.1.8.1.Raporti vjetor 2019-2020, raporti vjetor 2020-2021</i>) pyetësorët me studentët dhe ndryshimet e programeve të mbeshitura në VKM-ë dhe udhëzimin përkatës.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor si metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë anketimin e studentëve. Sipas RVB - së kjo procedure është kryer është kryer në nivel fakulteti, por nga vizita në institucion GVJ u informua se asnjë student i programit Bachelor Gjuhë dhe Letërsi Ruse, nuk ka qenë pjesmarrës.</p> <p>GVJ konstaton <i>mungesën një modeli specifik pyetësori për programin e Gjuhës dhe Letërsisë Ruse, lidhur me ndërtimin e syllabuseve, pasurimin të tyre, burimet që shfrytëzoheshin, motivimet, përfshirjen e studentëve në programin Erasmus+, motivimin për të vazhduar ciklin e dytë në degën e Gjuhës Ruse, dhe jo në degë të tjera.</i></p> <p><i>Evidencë 3.6 Pyetësori i studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.pdf</i></p> <p><i>3.7 Pyetësori i Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike; "vlerësimi i lëndës dhe i pedagogut".pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit përpiqet të kryejë vëzhgime të procesit mësimor gjatë gjithë vitit. Si hallkë e vlerësimit të cilësisë së institucionit përpiqet të përfshijë dhe studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni) të cilët ishi pjesmarrës dhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Institucioni vlerëson në mënyrë dhe periodike performancën e stafit akademik.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p><i>Evidencës 1.8.1. Raporti vjetor</i></p> <p><i>Evidencë 3.5.3 Raporti i veprimtarisë kërkimore shkencore</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>



**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka të përfshirë në Statut në Rregullore dhe në Planin strategjik për sigurinë e clësisë së brendshme edhe politikat për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. <i>(Evidencë 1.2.2 Strategjia e zhvillimit Dega e Gjuhes RUSE-pdf)</i></p> <p>Megjithëse në përbërje të NJSBC nuk ka student apo përfaqësues të jashtëm pasi programi Bachelor ka problem numrin e studentëve.</p> <p><i>GVJ rekomandon se do të ishte e nevojshme përfshirja në projekte që kanë focus sigurimin e cilësisë së brendshme, trajnim e përshtatjen e programeve me tregun e punës.</i> Informacionet e paraqitura nga departamenti janë premtuese por janë ende në fazën plan projekti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Komisioni të Sigurimit të Cilësisë ende nuk është finalizuar dhe rrjedhimisht, nuk ka krijuar një përvojë të vetën monitorimi apo reflektimi rreth programit. <i>(Evidencë 3.1.8 Urdhër vendim për organizimin dhe funksionimin e njsbc-së në nivel njësie kryesore.pdf)</i> Gjatë vizitës u konstatua si pikë pozitive është dëshira për të integruar student të të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve, në këto struktura duke u shpërndarë detyra dhe përgjegjësi. Megjithatë duhet të vërejmë se ky program kishte mangësi numrin e studentëve Asnjë prej tyre nuk ishte i punësuar në tregun e punës së këtij program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore. Në mungesë të një zyre të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel fakulteti, ky funksion është realizuar nga dekanati i cili bashkëpunon dhe shkëmben informacion me NJSBC për problemet e cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidencë 3.1.7 Rregullore për funksionimin e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.pdf)</i>. Vlerësimi i sigurisë dhe i cilësisë kërkon dhe bashkëpunimin dhe përfshirjen e gjithë aktorëve të departmentit dhe personelit ndihmës akademik që nga drejtorja e kurrikulës, drejtorja e edukimit. Sekretaritetë mësimore kanë statistika të plota dhe të detajura për arritjet e çdo studenti në këtë program studimi. Kjo pikë u vërtetua edhe gjatë vizitës së GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Pjesë përbërse e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm përveç stafit akademik të përzgjedhur konsiderohet si pike pozitive integrimi i studentëve duke shmangur çdo lloj diskriminimi në formë apo në përmabajtje. Parimisht dhe praktikisht nga përgjigjet e pyetësorve të ngarkuar Studentëve u garantohej anonimatit dhe liria e mendimit në çdo pyetësor. GVJ u informua se asnjë student i këtij programi nuk ishte i përfshirë në pyetësor.</p>




<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përvec integritetit të grupit të vlerësimit të brendshëm, universiteti përpiqet të përfshirë dhe faktorë të tjerë në proceset e vlerësimit për të siguruar mundësinë e më shumë opinioneve për të përmirësuar cilësinë programeve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat e sigurimit të brendshëm të cilësisë përgjithësisht konsiderohen transparente, dhe parimisht janë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit parimisht janë të publikuara në këtë faqe të hapur për të interesuarit. <i>(Evidencë 2.10 Politikat institucionale të publikimit të informacionit. pdf)</i></p> <p>Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë ku janë të aksesueshme përmes të gjithë grupet e interesit. Do të ishte në të mirë të procesit që për pikat e dobëta, rekomandimet të identifikoheshin dhe të diskutoheshin me grupet e interesit duke pasur edhe reflektimin dhe kjo do të ndihmonte në transparencën e plotë dhe në mundësinë e përmirësimit të mëtejshëm të grupit të vlerësimit të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, institucioni përpilon raportin dhe analizën e pyetësorve.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, parimisht janë transparente. Në raport është respektuar etika akademike, të dhenat janë përcjellë primisht saktë por disa informacione nuk janë përcjellë. Për informacione të rëndësishme dhe në bazë të ligjit 48/ 2012 janë repektuar parimet e konfidencialitetit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka përshkruar pikat e forta dhe pikat e dobëta të shoqëruara dhe me rekomandimet përkatëse duke u mbështetur dhe në rezultatet e pyetësorëve të cilët gjithsesi, nuk janë të specifikuar për këtë program studimi. Përsa i përket rekomandimeve mbeten të përgjithshme në formë.</p> <p><i>.Evidencë 3.1.9 Urdhër i Dekanit për ngritjen e GVB –së. pdf -</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe diskutuar një planin e përmirësimit të sigurimit të cilësisë edhe për këtë program, ku ka nxjerr ne pah pikat e forta dhe të dobëta. <i>Gjithsesi në planin e përmirësimit është konsideruar ngritja një grupi pune, por mbetet i paqartë se çfarë metode do të ndjekë për përmirësimin e pyetsorëve dhe realizimine tyre me student që ndjekin këtë program.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni organizon veprimtari periodike me qëllimin e informimit dhe ndërgjegjësimin e studentëve me anë të seminareve dhe trajnimeve informuese. Gjithsesi të qënit konkret në të ardhmen dhe jo vetëm planifikim, i Komisionit të Përhershëm të Cilsësë do të ndihmonte në qartësimine formës së bashkëpunimit të stafit akademik dhe studentëve të këtij program në të ardhmen.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X





**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Ruse” me profil “Përkthim dhe interpretim” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit është i ngjashëm me programet e studimit të degëve të tjera, në sillabuse.
2. Programi ka në përbërje një staf akademik me kualifikimin e duhur shkencor ku ndërthurret përvoja e stafit më me përvojë me atë më të ri.
3. Ekziston një klimë bashkëpunimi midis njësisë bazë dhe organeve drejtuese të fakultetit dhe të universitetit.
4. Ka një staf mbështetës të përkushtuar dhe në dispozicion të studentit dhe pedagogut.
5. Infrastruktura e mirë dhe e mjaftueshme (auditoret dhe laboratorë)
7. Biblioteka ishte e pasur me ambiente cilësore.

**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e numrit të studentëve në të gjitha vitet e këtij program studimi. **(Standardi V.1)**
2. Mungesa e njohjes së tregut të punës, mungesa e një databaze për të diplomuarit. **(Standardi I.3, kriteri 2)**
3. Mospasja e një pyetori specifik të matjes së cilësisë për këtë program studimi duke pasur parasysh dhe arsyen dhe mungesën e numrit të studentëve. **(Standardi VI.2, kriteri 3)**
4. Mungesa e parashikimit të praktikës profesionale në ciklin e parë. **(Standardi I.1, kriteri 3)**
5. Përditësimi i bibliotekës me tituj të rinj lidhur me këtë program studimi. **(Standardi II.3, kriteri 4)**

**Rekomandime:**

1. Shtimi i numrit të studentëve në të gjitha vitet e këtij program studimi. GVJ rekomandon mundësisë së shkëmbimit të studentëve edhe gjatë ciklit të parë të studimeve. Kjo mundësi do të ndihmonte në grishjen e studentëve për të aplikuar edhe në ciklin e parë të studimeve.
2. Studimi i tregut të punës dhe punësimi i studentëve të jetë periodik dhe bazuar mbi një databazë, jo spontan. Në këtë kuadër GVJ rekomandon që institucioni për të parashikuar vijueshmërinë e programit dhe planifikuar ecurinë e tij duhet të kyejë përditësojë database e departamentit me gjithë alumni që dhe punët që ata bëjnë aktualisht.
3. Përfshirja e të gjithë aktorëve (pedagogë, studentë, e staf ndihmës) në proceset e vlerësimit të cilësisë, sepse kjo do të sjellë edhe një opinion unik të tyre për këtë proces si dhe do të rrisë kulturën e matjes së cilësisë. GVJ rekomandon se do të ishte e nevojshme përfshirja

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 60



në projekte që kanë focus sigurimin e cilësisë së brendshme, trajnim e përshtatjen e programeve me tregun e punës. Informacionet e paraqitura nga departamenti janë premtuese por janë ende në fazën plan projekti.

4. Përditësimi i bibliotekës me tituj të rinj lidhur me këtë program studimi. GVJ sugjeron pasurimin edhe me më shumë libra të bibliotekës online, të cilat do i vijnë në ndihmë procesit të mësimdhënies. Grupi rekomandon që institucioni duhet të përditësojë dhe pasurojë bibliotekën me tituj cilësorë e të rinj në ndihmë të studentëve, ose nga buxheti i programuar të ofrojë abonim në revista shkencore ose në biblioteka digjitale të univeriteteve të njohura që kanë të njëjtin program studimi, të cilat ofrojnë kundrejt pagesës studime cilësore. Do të ndihmonte në grishjen e studentëve për një qasje me reflektive.
5. Rritja e punës shkencore nga stafi akademik me artikuj shkencorë e pjesëmarrje në konferenca. Një artikull shkencor në vit, siç na u tha në takimin me stafin akademik i vendosur me vendim Senati, për anëtarët e stafit akademik na u duk një kriter shumë minimal për nxitjen e punës shkencore. Prandaj GVJ sugjeron se orientimi drejt shkëmbimit të eksperiencave ndërkombëtare me anë të bursave Erasmus është ndihmuese në kualifikimin e mëtejshëm profesional. Gjatë konsultimit me dokumentacionin në rang institucioni ishin hartuar disa projekte bashkëpunimi me universitete jashtë kufijve, por stafi akademik i këtij programi studimi nuk ishte i përfshirë ende.





**Conclusions of the evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Russian Language" with profile "translation and interpretation" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"**

**Strengths and Affirmations:**


1. The study program is similar to the study programs of other branches, referring syllabuses.
2. The program is composed of an academic staff with the appropriate scientific qualification, where the experience of the most experienced staff is combined with the youngest.
3. There is a climate of cooperation between the basic unit and the governing bodies of the faculty and the university.
4. There is a dedicated support staff available to the student and the lecturer.
5. Good and sufficient infrastructure (auditoriums and laboratories)
7. The library was rich with qualitative settings.

**Weak points:**

1. Lack of students in all years of this study program. **(Standard V.1)**
2. Lacking knowledge regarding labor market, lack of a database for graduates. **(Standard I.3, criterion 2)**
3. Not having a specific quality measurement questionnaire for this study program considering the reason and the lack of the number of students. **(Standard VI.2, criterion 3)**
4. Lack of provision of professional practice in the first cycle. **(Standard I.1, criterion 3)**
5. Updating the library with new titles related to this study program. **(Standard II.3, criterion 4)**

**Recommendations:**


1. Increasing the number of students in all years of this study program. EEG recommends the possibility of student exchange even during the first cycle of studies. This opportunity would help encourage students to apply even in the first cycle of studies.
2. The study of the labor market and the employment of students should be periodic and based on a database, not spontaneous. In this framework, EEG recommends that the institution, in order to predict the continuity of the program and plan its progress, should be able to update the database of the department with all the alumni and the jobs they currently do.
3. Involvement of all actors (lecturers, students, and support staff) in quality assessment processes, because this will also bring their unique opinion about this process and increase the culture of quality measurement. The Group recommends that it would be necessary to be





involved in projects that focus on internal quality assurance, training and adaptation of programs to the labor market. The information presented by the department is promising but is still in the project plan stage.

4. Updating the library with new titles related to this study program. EEG suggests enriching the online library with even more books, which will help the teaching process. It recommends that the institution should update and enrich the library with quality and new titles to help students, or from the programmed budget offer subscription to scientific journals or digital libraries of recognized universities that have the same study program, which offer qualitative studies. It would help to attract students for a reflective approach.
5. Increasing of the scientific work by academic staff with scientific articles and participation in conferences. A scientific article per year, as we were told in the meeting with the academic staff decided by the Senate, for members of the academic staff seemed a minimal criterion for the promotion of scientific work. Therefore, EEG suggests that the orientation towards the exchange of international experiences with through Erasmus scholarships is helpful in further professional qualification. During the consultation with the documentation at the institution level, several cooperation projects with universities outside the borders were drawn up, but the academic staff of this study program was not yet involved.





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	